

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Raport VJETOR 2013



Tiranë, 2014

Përgatitur nga:
Kryesia e Akademisë së Shkencave e Shqipërisë
Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike
Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike

Nën drejtimin e:
Akad. Prof. Dr. Salvatore Bushati

Redaktore:
Albana Velianj

Kompjuterizimi
Enkelejda Misha

Adresa:
Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Sheshi Fan S. Noli, Tirana, Albania
Tel: 00355 4 2259657
Tel/Fax: 00355 4 2227476

Shtypur në shtypshkronjën "Kristalina KH"
Tiranë, 2014

PJESA E PARË

Veprimtaritë Kryesore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë gjatë vitit 2013

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, gjatë vitit 2013 ka synuar realizimin e funksioneve të saj në disa drejtime përparësore, nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive dinamike, të cilat duke iu referuar krahasimit të treguesve të arritur (që lidhen me aktivitetin kërkimor bazë: të zbatuar apo eksperimental, fushat e kërkimit, burimet njerëzore, shpenzimet), evidentojnë arritje mjaft pozitive krahasuar me ato të një viti më parë.

Treguesit e mëposhtëm pasqyrojnë rezultatet që ka arritur ASHSH gjatë vitit 2013.

Stafi akademik sot përbëhet nga 26 “Akademikë”: 3 “Akademikë të përhershëm”, 11 “Akademikë të asociuar” dhe 2 “Akademikë” në politikë, të cilët sipas fushave të kërkimit, zhvillojnë veprimtaritë në seksione (Fig.1).





Fig. 1. Përbërja e stafit akademik të ASH, sipas seksioneve (2013)

Gjatë vitit 2013, **Seksioni i shkencave shoqërore e albanologjike** ka patur 17 anëtarë dhe **Seksioni i shkencave natyrore e teknike** 22 anëtarë.


Treguesi i moshës së anëtarëve të Asamblesë në vitin 2013, krahasuar edhe me atë të vitit 2012, paraqitet në Fig. 2.

Fig. 2. Staf i akademik sipas klasave të moshës në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012




Treguesit ekonomike të ASHSH gjatë vitit 2013, rezultojnë si më poshtë:

Fig. 3. Realizimi i buxhetit sipas zërave



Shpenzimet e kryera me fondet e buxhetit të planifikuar, u realizuan 100%.

Fig. 4. Realizimi Plan - Fakt






Fig. 5. Realizimi i krahasuar i buxhetit

Nga grafikët e mësipërm, vihet re dinamika e realizimit të treguesve ekonomikë, financiarë e atyre monetarë.

ASHSH e zhvillon veprimtarinë e saj përmes dy seksioneve, përkatësisht **Seksionit të shkencave shoqërore e albanologjike** dhe **Seksionit të shkencave natyrore e teknike**.

Gjatë vitit akademik 2013, puna e seksioneve është shtrirë kryesisht në mbulimin e veprimtarive kërkimore-shkencore të parashikuara nga përparësitë dhe detyrat e shtrura nga analiza e vitit 2012, por edhe në veprimtari të tjera që lidhen me:

- detyrat e parashikuara nga institucionet, ku anëtarët e seksionit janë punonjës efektivë;
- detyrat vetjake të çdo anëtari të seksionit, ose me projekte të mbështetura nga organizma kombëtarë ose ndërkombëtarë.

Për arsye të strukturës, pa institute apo qendra kërkimore në varësi të Akademisë së Shkencave, veprimtaria e çdo çdo anëtari të seksionit është mbështetur, në radhë të parë, në punën individuale ose në veprimtari kërkimore-shkencore, që u përgjigjen kërkesave të institucioneve, ku akademikët janë efektivë. Anëtarët e seksioneve përgjithësisht janë punonjës të universiteteve, prandaj edhe veprimtaria kryesore e tyre ka qenë, kryesisht, në mbështetje të kërkimit shkencor dhe në hartimin e teksteve e të veprave monografike të veçanta në fusha të ndryshme të shkencës. Ata janë edhe drejtues të veprimtarive kryesore shkencore në këto institucione, dhe njëherësh ndërlidhës e koordinues me Akademinë e Shkencave, ndaj përgjithësisht, lidhja e tyre ka qenë e dyfishtë; në këto kushte, edhe raportimi e vlerësimi kanë qenë të dyanshëm. Seksionet, në varësi të kushteve, kanë përkrahur dhe mbështetur veprimtarinë e anëtarëve në bashkëpunimin e ofruar nga çdo anëtar.

Anëtarët e **Seksionit të shkencave shoqërore dhe albanologjike** kanë ndërmarrë disa veprimtari kërkimore-shkencore të karakterit të gjerë a të ngushtë, në varësi të kërkesave individuale apo institucionale

jashtuniversitare mbi bazë projektesh, të mbështetura kryesisht nga organizata kombëtare apo ndërkombëtare, si: UNDP, USAID, OSBE etj.

Anëtarët e seksionit kanë qenë pjesëmarrës në veprimtaritë kërkimore-shkencore të të gjitha niveleve, thuajse në të gjitha fushat që mbulon ky seksion.

Një praktikë e mirë ka qenë përgatitja dhe drejtimi i projekteve në disa fusha, mbështetur kryesisht nga organizma ndërkombëtarë, e në raste shumë të kufizuara, nga institucione shtetërore. Projektet trajtojnë tema të rëndësishme nga:

1. *Sociologjia*: për metodologjinë si pjesë e formimit qytetar; për ndikimin e marrëdhënieve publike në informacionin masiv; për dukuri të dhunës në familje; për dhënie rekomandimesh në përmirësimin e shërbimeve publike të emigrantëve etj.;

2. *Drejtesia*: për njohjen dhe zbatimin e standardeve të barazisë gjinore në proceset gjyqësore; për forcimin e transparencës, efektshmërisë dhe paanësisë në proceset gjyqësore;

3. *Historia*: për kërkime në arkivat e huaj për dokumentimin e ngjarjeve të historisë së Shqipërisë në shekullin XX;

4. *Gjuhësia*: për hartimin e *Fjalorit etimologjik të shqipes*; për përmirësimin e gjuhës standarde etj.

Një vend relativisht të mirë dhe të dukshëm në veprimtarinë shkencore të seksionit, zënë botimet. Me gjithë vështirësitë e njohura financiare, gjatë vitit 2013 u botuan monografi të veçanta dhe përmbledhje studimesh. Kështu, u botuan dy përmbledhje studimesh: një me studime nga arkeologjia dhe një tjetër me referime të konferencës ndërkombëtare, të organizuar me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë. Monografi të veçanta janë botuar për shqipen standarde, për përfaqësues të kulturës letrare; për tranzicionin e ekonomisë shqiptare; për probleme të papunësisë; për minoritetet; për viktimat e krimit në familje; për traditat kulturore e zakonore shqiptare sipas autorëve të huaj; për studime historike mbi çështjen kombëtare etj. Ka gjithashtu edhe botime jashtë vendit në fushën e sociologjisë dhe antropologjisë.

Nëpërmjet formimit akademik dhe veprimtarive shkencore, anëtarët e seksionit kanë dhënë ndihmesë të drejtpërdrejtë:

- Në mësimdhënie në universitete dhe shkolla të larta. Pjesa më e madhe e anëtarëve të seksionit janë angazhuar në leksione universitare, në nivel masteri dhe doktorature.

- Në hartime programesh dhe udhëheqje doktoratash etj.

Ky produkt shkencor i përgjithshëm i seksionit, në këtë gjendje strukturore- administrative të Akademisë, në përgjithësi ka qenë i mbyllur, në pikëpamje të njohjes së tij. Vetëm në raste të kufizuara, botimet shkencore të çdo lloji janë bërë të njohura përmes paraqitjes në Akademinë e Shkencave; edhe më pak të njohura kanë qenë këto veprimtari jashtë Akademisë.

Për të bërë të njohur, kryesisht veprimtarinë botuese të veprave me

rëndësi, Seksioni i shkencave shoqërore dhe albanologjike ka nisur organizimin e referimeve akademike që synojnë:

1. Paraqitjen e referimeve shkencore për veprat e tyre shkencore ose parashtrimin e çështjeve themelore problemore që lidhen me fusha të caktuara të shkencave shoqërore dhe albanologjike. Referimet parashtrihen para një auditori specialistësh të fushës, të cilët paraprakisht janë njohur me tezat kryesore të veprës përkatëse dhe me zgjidhjet e dhëna nga autori, për të dhënë mundësinë e një diskutimi pasues efektiv.

2. Gjallërimin dhe evidentimin e punës shkencore të çdo anëtari të seksionit.

3. Motivimin për punë të mëtejshme shkencore.

4. Kthimin e referimeve dhe diskutimeve të këtij lloji në traditë.

Përgjithësisht, anëtarët e seksionit janë të interesuar për referime të kësaj natyre, sepse kjo është një nga rrugët për njohjen e punës së tyre shkencore dhe nga ana tjetër, nuk paraqet ndonjë vështirësi për t'u organizuar.

Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike, për vitin 2013 ka patur përparësi të tij veprimtari të orientuara në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacionit dhe të studimeve të orientuara qeveritare në fusha të tilla si: rregullimi i regjimit ujor në sistemet liqenore dhe të lumenjve; shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme (gjeotermale, nga biomasa etj.) dhe aplikimet praktike me projekte pilote me synim ngritjen e NMV-ve në Shqipëri; vlerësimi i fenomeneve të ndotësve të ajrit dhe impakti në mjedis; përforcimi i sistemit të monitorimit të mjedisit në vend; projekte në fushën e nanoteknologjisë, të lidhura me mjedisin, në mjekësi etj.; teknologjitë e informimit e komunikimit dhe shfrytëzimi i tyre gjatë krizave mjedisore dhe në fusha të tjera; vlerësimi, ruajtja dhe rehabilitimi i ekosistemeve natyrore, pyjeve dhe problematikat e menaxhimit të tyre; biodiversiteti dhe shfrytëzimi i tij në cilësinë e ushqimit, të përdorimit të bimëve aromatike mjekësore; transferimi dhe zbatimi i teknologjive të reja në fusha të ndryshme e me përparësi si ato të çertifikimit të patologjive të specieve frutore me metoda bashkëkohore, në fushën e trashëgimisë kulturore etj.

Këto veprimtari janë zhvilluar në kuadër të disa marrëveshjeve e projekteve të bashkëpunimit që ka ASHSH me akademi e institucione të tjera, si Marrëveshja e Bashkëpunimit Shkencor me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi; Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim i AKTI-t; projektet dypalëshe në rajon, ato të qeverisë etj. Një kontribut të veçantë kanë dhënë koordinatorët e projekteve të mbështetura nga Komisioni European, programi IPA, UNESCO, TEMPUS NATO, fondacione kombëtare të kërkimit dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë, si dhe nëpërmjet punës individuale të akademikëve në sektorët ku punojnë, të cilat janë realizuar nëpërmjet projekteve, konferencave, *workshop*-eve, këshillimeve kombëtare e ndërkombëtare.

Viti 2013 ka qenë viti i organizimit të **Konferencës shkencore ndërkombëtare “Sistemi liqenet e Prespës-liqeni i Ohrit”: Gjendja aktuale–probleme dhe perspektiva**. Kjo konferencë u përgatit për një kohë të gjatë, kryesisht nga **Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike**, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë dhe u mbajt me sukses më 29-31 tetor 2013.

Një ngjarje tjetër e rëndësishme shkencore ka qenë organizimi i **Kongresit të 7-të ndërkombëtar të Gjeofizikanëve në Shqipëri**, një veprimtari shkencore ndërkombëtare me rëndësi për kërkimin shkencor dhe zhvillimin ekonomik, për Shqipërinë e më gjerë.

Po kështu, u zhvillua **Simpoziumi ndërkombëtar “Biodiversiteti, ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm për zhvillimin rural”** (edicioni IX), në bashkëpunim me disa institucione shkencore dhe shoqata në vend, një traditë tashmë me rëndësi të veçantë në Shqipëri.

Ndërkaq është në vazhdim puna për organizimin e **Konferencës së 8-të për bimët aromatike mjekësore, e vendeve të Europës Juglindore** në bashkëpunim me UBT dhe Shoqatën për bimët aromatike mjekësore (BAM) e vendeve të Europës Juglindore (AMAPSEEC), që do të mbahet në Tiranë, në maj 2014.

Një vend të veçantë kanë zënë aktivitetet në kuadër të **Programit “Edukimi në shkencë”**, një nismë e akademive të Europës, që ka për qëllim paraqitjen e ideve, që dalin nga studime shkencore të specialistëve brenda dhe jashtë akademive, të cilat shpalosen për diskutim në auditor, në një rreth të gjerë kërkuesish. Programi realizohet nëpërmjet organizimit të seminareve shkencore, leksioneve të hapura, të ilustruara nëpërmjet arritjeve të figurave të shquara të shkencës, apo me organizimin e “Ditëve të hapura të institucioneve shkencore”.

Anëtarët e seksionit kanë marrë pjesë aktive në shumë konferenca shkencore, në veçanti, ndërkombëtare (rreth 70 konferenca) duke paraqitur rezultatet e punës së tyre kërkimore. Botimet e kryera gjatë vitit 2013 nga anëtarët e **Seksionit të shkencave natyrore dhe teknike** kanë qenë të shumta në numër, por ka qenë e pakët mundësia që ato të mbështeten financiarisht nga fondet e Akademisë së Shkencave. Përsa i përket artikujve në revistat shkencore gjatë vitit 2013, anëtarët e seksionit dhanë ndihmesën për përgatitje të botimeve me vlerë, mjaft prej të cilëve në revista të huaja të vlerësuara me *faktor impakti*. Në to paraqiten rezultate të projekteve të drejtuara nga akademikët, si dhe rezultate të doktoraturave, të udhëhequra prej tyre.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2013, të gjithë anëtarët e seksionit me përgatitjen e tyre cilësore shkencore kanë dhënë kontribut në mësimdhënie, në universitete publike dhe private. Në një masë më të madhe janë angazhuar në udhëheqje të doktoraturave dhe të masterit në fusha me rëndësi si: teknologjia informatike; metodat e inxhinierisë kimike e të prodhimit të pastër në procese të ndryshme prodhimi; studimi dhe përdorimi i nanostrukturave; studimi i aerosoleve si ndotës; shëndeti dhe parandalimi i sëmundjeve; përdorimi i metodave bioteknologjike bimore në klonim, shëndetësim dhe konservim të

gjermoplazmës bimore; në prodhimin e metaboliteve sekundarë; përdorimi i metodave të algjebrës etj.

Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike ka punuar gjithmonë në bashkëpunim me grupet kërkimore të universiteteve. Memorandumet e Bashkëpunimit me Universitetin e Tiranës, me atë Politeknik të Tiranës, me Universitetin Bujqësor, me disa universitete publike dhe private kanë qenë mjet për të realizuar projekte shkencore, botime dhe konferenca me rëndësi. Kështu, në vitin 2013, për çështje të rëndësishme të veprimtarive u ngritën komitete *ad-hoc*, si për njohjen e vlerësimit e gjendjes, organizimin e veprimtarive, e deri në hartimin e përfundimeve e deklaratave, drejtuar politikëbërësve dhe organeve ekzekutive të vendit. Eksperiencat e kësaj përvoje pozitive, ASH do t'i zhvillojë më tej në drejtim të kërkimit e zhvillimit shkencor me anë të:

- Komisioneve *ad-hoc* për probleme kryesore të zhvillimit të vendit;
- Rrjeteve të bashkëpunimit me specialistë në fusha të ndryshme, ku mund të veçojmë energjetikën, mjedisin, menaxhimin e ujërave, emergjencat civile, bioteknologjinë, gjeologjinë, klimën, sizmologjinë etj.;
- Rrjeteve të bashkëpunimit me grupe të veçanta të kërkuesve të ndryshëm, që duhen stimuluar nga politikat shkencore të ASH, si femrat shkencëtare, kërkuesit e rinj shkencorë etj.

Duhet theksuar, se për zhvillimin e veprimtarive të ASH, në projektet, botimet, organizimin e konferencave etj., të ndërmarra nga seksioni, investimet direkte nga qeveria kanë qenë minimale, në krahasim me kërkesat reale. ASH në shumicën e rasteve ka përdorur fonde nga projekte të institucioneve shkencore akademike të huaja si: fonde të Rrjetit të Akademive të Botës, të InterPanelit të Akademive të Shkencave (IPA), Rrjetit të Akademive të Shkencave të Europës (ALLEA), si dhe të organizmave ndërkombëtarë shkencorë që mbështesin projekte të rëndësishme në Shqipëri. Ndër to, Banka Gjermane KfW nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, që po implementon projektin “Transboundary Biosphere Reserve Prespa – Support to the National Prespa Park in Albania” bëri të mundur mbështetjen financiare dhe shkencore për realizimin e Konferencës shkencore ndërkombëtare “*Sistemi liqenet e Prespës-liqeni i Ohrit: Gjendja aktuale–probleme dhe perspektiva*”.

Një rrugë efikase për gjetjen e fondeve plotësuese, do të ishte paraqitja e projekteve të ASHSH pranë institucionit shtetëror, që administron fondet për kërkimin shkencor: Agjencisë Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit.

Natyrisht, mbështetja financiare edhe nga institucionet, ku punon çdo anëtar, edhe nga institucioni i Akademisë ka qenë e kufizuar e nganjëherë krejt e mangët, për shkak të buxhetit të paktë ose të munguar, brenda buxhetit të parashikuar të çdo institucioni.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar përditësimit të faqes së internetit të ASH, duke pasqyruar të gjitha veprimtaritë e ASH, por mbetet që të përmirësohet puna duke e pasuruar më tej atë.

PJESA E DYTË

Veprimtaritë e seksioneve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Gjatë vitit akademik 2013, puna e seksioneve të Akademisë është shtrirë kryesisht në mbulimin e veprimtarive kërkimore-shkencore të parashikuara nga përparësitë dhe detyrat e shtruara nga analiza e vitit 2012, por edhe në veprimtari të tjera lidhur me detyrat vetjake. Këto veprimtari janë zhvilluar nëpërmjet projekteve, konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare (brenda e jashtë vendit), botimeve të monografive, revistave periodike shkencore, udhëzuesve, botimeve të veçanta e atyre për publikun e gjerë, mësimdhënies në nivelet e ndryshme të arsimit të lartë e të kualifikimit shkencor, përmes takimeve publike, pranisë në median e shkruar e atë televizive, në pjesëmarrjen me ekspertiza e këshillime, në hartimin e programeve në nivele të ndryshme institucionale etj.

I. Seksioni i shkencave shoqërore dhe albanologjike

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar puna mbi disa projekte të parashikuara në planet afatshkurtra dhe afatgjata të Seksionit të shkencave shoqërore dhe albanologjike. Anëtarët e seksionit kanë ndërmarrë disa veprimtari kërkimore-shkencore mbi bazë projektesh, të mbështetura kryesisht nga organizata kombëtare apo ndërkombëtare në fusha me rëndësi si sociologji, drejtësi, histori, nëpërmjet arkivave të huaj, në gjuhësi, për hartimin e *Fjalorit etimologjik të shqipes*; për përmirësimin e gjuhës standarde etj. Projekte me rëndësi janë realizuar ose janë në vazhdim nga akademiçkët: A. Fuga, K. Barjaba, A. Anastasi, B. Meta, K. Topalli, nga Këshilli Ndërkademiçk për Gjuhën Shqipe etj.

Ka një pjesëmarrje të gjerë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arkeologjisë nga akad. M. Korkuti; në fushën e sociologjisë nga akad. A. Fuga dhe akad. as. K. Barjaba; në fushën e drejtësisë nga akad. as. A. Anastasi; në fushën e ekonomisë nga akad. A. Angjeli; në fushën e historisë nga akad. B. Meta dhe akad. as. M. Verli; në fushën e gjuhësisë nga akad. K. Topalli, akad. E. Likaj dhe akad. as. Gj. Shkurtaj; në fushën e letërsisë nga akad. J. Bullo dhe akad. F. Dado etj.

Një kontribut të mirë thuajse nga të gjitha fushat e studimeve shoqërore ka në revistat tona shkencore dhe të huaja, ku veçohen: A. Fuga, K. Topalli, A. Angjeli, V. Tole, K. Barjaba, B. Meta, M. Verli.

Gjatë vitit 2013, anëtarët e Seksionit të shkencave shoqërore e albanologjike kanë realizuar:

- 12 projekte shkencore (1 projekt nga Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; 1 projekt në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim – AKTI; 10 projekte në kuadër të programeve të BE (FP-7 dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtarë);
- 8 konferenca shkencore (1 ndërkombëtare dhe 7 kombëtare);
- 25 monografi (18 brenda dhe 7 jashtë vendit);
- 19 artikuj në revista shkencore (9 jashtë dhe 10 brenda vendit);
- 46 pjesëmarrje në konferenca shkencore (28 jashtë dhe 18 brenda vendit);
- pjesëmarrje në procesin e mësimit dhe të gjithë “Akademikëve” dhe “Akademikëve të asociuar” të këtij seksioni të ASHSH.

Grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë ecurinë e treguesve për vitin 2013 dhe atë pesëvjeçar 2009-2013.




Fig. 6. Realizimet për vitin 2013 të Seksionit të shkencave shoqërore e albanologjike




Fig. 7. Realizimet për vitet 2009-2013 të këtij seksioni

II. Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike

Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike për vitin 2013 ka pasur përparësi të tij veprimtari shkencore dhe botuese në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacionit dhe të studimeve të rëndësishme për ekonominë, mjedisin, shëndetin etj. Veprimtaritë e seksionit janë zhvilluar kryesisht në kuadër të projekteve të Akademisë, në bashkëpunim me institucione të tjera shkencore, si dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Maqedonisë, si dhe të Malit të Zi. Një pjesë e mirë e veprimtarive janë realizuar në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim të AKTI, të projekteve dypalëshe në rajon etj., për të cilat koordinatorë të projekteve janë anëtarët e seksionit.

Një kontribut të veçantë anëtarët e seksionit kanë dhënë në drejtim të koordinimit në projekte ndërkombëtare, që janë realizuar ose janë në vazhdim si akademikët S. Bushati, N. Frashëri, F. Vila, akademikët e asociuar E. Kongjika, I. Malollari; ndër ata që punojnë jashtë vendit veçohet akad. A. Merkoçi, akad. N. Gruda, akad. as. A. Durrësi etj. Do të ishte me dobi që akademikët që punojnë në institucione shkencore të avancuara jashtë vendit, të forcojnë lidhjet me asamblenë dhe të gjejnë mënyra reale bashkëpunimi me specialistët në vend, nëpërmjet programeve ku ata punojnë, por edhe bashkëpunimi në programet europiane, si ai "Horizon 2020" e më gjerë.

Viti 2013 ka qenë viti i organizimit të disa konferencave shkencore me vlerë jo vetëm për komunitetin shkencor, por edhe më gjerë për politikëbërësit e vendimmarrësit.

Aktivitetet në kuadër të **Programit "Edukimi në shkencë"**, si përvojë e filluar pak vite më parë me referime të akad. A. Merkoçi dhe akad. as. A. Veveçka, këtë vit vazhduan me paraqitjen e kërkimit në fushën e bioteknologjisë bimore nga akad. as. E. Kongjika. Gjithashtu për të përkujtuar veprën e *doc. Ligor Lubonja, si një figurë e paharruar për kontibutin e çmuar në shkollën e gjeofizikës shqiptare* u organizua një takim me specialistë të fushës, pedagogë e studentë. Në kuadër të Programit "Edukimi në Shkencë" u përruruan vepra të arrira si libri **"Bazat e virusologjisë bimore"**, me autor prof. as. A. Myrta etj. Megjithatë, ky program duhet të jetë më i gjerë, ku të përfshihen dhe anëtarët e tjerë të seksionit, akademikë dhe akademikë të asociuar, që punojnë në fusha të vlerësuara të shkencave natyrore dhe teknike.

Anëtarët e seksionit kanë marrë pjesë aktive në shumë konferenca shkencore, ku kanë paraqitur rezultatet e punës së tyre kërkimore. Më aktivë janë akademikët A. Merkoçi në fushën e nanoteknologjisë, N. Frashëri në fushën e teknologjisë së informacionit, S. Bushati në fushën e gjeofizikës, N. Gruda në fushën e bujqësisë, B. Resuli në fushën e mjekësisë etj., si dhe akademikët e asociuar E. Kongjika në fushën e bioteknologjisë bimore, I. Malollari në fushën e inxhinierisë kimike e mjedisit, A. Durrësi në fushën e teknologjisë së informacionit etj.

Në fushën e botimeve të kryera gjatë vitit 2013, vlen të veçohet puna e realizuar nga akad. as. E. Pinguli për botimin e 6 monografive, ku pasqyrohen probleme të ndërtimit të HEC-eve, të përdorimit të energjisë së rinovueshme etj. Përsëri, si çdo vit, numri i artikujve të botuar nga anëtarët e seksionit në revista të huaja ka qenë mbizotërues (87), në krahasim me ata të botuar në vend (13). Botime në numër të madh kanë realizuar akad. A. Merkoçi, akad. as. I. Malollari, E. Kongjika, A. Durrësi, akad. F. Vila, N. Gruda, S. Bushati, N. Frashëri, B. Resuli, Dh. Haxhimihali. Akad. as. A. Veveçka dhe E. Kongjika kanë botuar në revista me faktor impakti, përkatësisht në fushën e fizikës së materialeve dhe të fiziologjisë, ekologjisë dhe biologjisë molekulare.

Mësimdhënia dhe udhëheqja e doktoraturave dhe e masterave ka qenë objekt kryesor i punës së anëtarëve të seksionit. Nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit me universitete të ndryshme, janë organizuar shumë veprimtari shkencore të përbashkëta. Janë ngritur komitete *ad-hoc*, për diskutime të problemeve të mprehta të mjedisit, të ekonomisë, shëndetit etj.

Komunikimi i anëtarëve të seksionit ka ardhur duke u rritur, në drejtim të diskutimit të problematikave të kohës. Të tilla kanë qenë ato të shtruarra për diskutim nga përgjegjësi i seksionit, akad. Dh. Haxhimihali, në mbledhje të posaçme për çështje themelore të jetës shkencore të seksionit e të Asamblesë, në lidhje me:

- kompetencat që duhet të ketë ASH në politikat e kërkimit shkencor në vend;

- nevojat dhe rrugët e riorganizimit sërish të sistemit të kërkimit shkencor në institute të pavarura kërkimi, duke i vendosur ato në varësi të ASH, apo të universiteteve etj;

- rrugët e rritjes së mëtejshme të nivelit të kërkimit shkencor, matur kjo nëpërmjet botimeve të artikujve shkencorë, sidomos të monografive, të angazhimit në projekte të rëndësishme kërkimore, të cilat sjellin kontribut në zgjidhjen e problemeve aktuale të vendit etj.;

- rritjen e mëtejshme të nivelit të bashkëpunimit të ASHSH me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nëpërmjet studimeve, projekteve, botimeve të përbashkëta etj.;

- përparësitë për zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e shkencave natyrore e teknike: energjetika, shfrytëzimi i pasurive natyrore, mjedisi, flora e fauna e vendit, burimet ujore, në zbatim të programit të ri të qeverisë;

- forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të ASH me qendrat e grupet kërkimore të universiteteve e qendrave të tjera kërkimore, e në veçanti të bashkërendimit të mëtejshëm me Agjencinë Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit, ku kërkohet që AKTI të rritë më tej funksionimin e vet;

- strategjinë që duhet ndjekur për gjetjen e burimeve plotësuese të financimit për ASH etj., për investimet në shkencë në raport me PPB në vend;

- përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë tipografike të botimeve, që ka

qenë dhe është mjaft e dobët (letra, figurat, lidhja, kapaku etj.), krahasuar me botimet përkatëse të realizuara nga akademitë e shkencave në rajon, si p.sh., ajo e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi; kjo për shkak të fondeve tepër të kufizuara për botim që zotëron ASHSH. Si shembuj pozitivë mund të sillen *Fjalori enciklopedik shqiptar*, botimi i ri, botimi jubilar *40 vjet Akademi e Shkencave e Shqipërisë* etj.;

- si të forcohet roli dhe pavarësia e seksioneve dhe debati i vazhdueshëm brenda tyre mbi problemet kërkimore të vendit e çështjet lidhur me funksionimin e Akademisë. Në veçanti, meriton t'i kushtohet vëmendje rolit e kontributit të akademikëve, të cilët aktualisht jetojnë e punojnë jashtë vendit, dhe mundësive të rritjes së kontributit të tyre;

Duke qenë probleme kyçe jo vetëm për mbarëvajtjen e punës, por edhe më gjerë, të lidhura me të ardhmen e kërkimit shkencor në Shqipëri, ato kanë ndezur debatin në seksion. Si rezultat i diskutimeve, do të përgatitet një material përmbledhës i opinioneve dhe pas miratimit nga seksioni, do të paraqitet në Kryesinë e Akademisë e do të bëhet objektiv i veprimtarive të viteve në vazhdim.

Mendojmë që roli i akademikëve që punojnë jashtë vendit të rritet nëpërmjet angazhimit të tyre në grupe pune për politikat e kërkimit shkencor, në organizimin e konferencave, etj., por veçanërisht në mbështetjen për të konkuruar së bashku me institucionet shqiptare shkencore në projekte me rëndësi rajonale apo më gjerë. Kjo kërkon angazhimin më intensiv të tyre, me gjithë kohën e kufizuar, për probleme jashtë aktivitetit të tyre në institucionet ku ushtrojnë aktivitetin shkencor.

Gjatë vitit 2013, anëtarët e Seksionit të shkencave natyrore e teknike kanë realizuar:

- 33 projekte shkencore, nga të cilat: 4 projekte në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim – AKTI; 2 projekte nga Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; 23 projekte në kuadër të programeve të BE (FP-7 dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtarë); 4 projekte të Akademisë së Shkencave dhe institucioneve të tjera në vend.

- 6 konferenca shkencore (3 ndërkombëtare dhe 3 kombëtare);
- 15 monografi (12 brenda dhe 3 jashtë vendit);
- 100 artikuj në revista shkencore (13 brenda dhe 87 jashtë vendit);
- 71 pjesëmarrje në konferenca shkencore (2 brenda dhe 69 jashtë vendit);

- pjesëmarrje në procesin e mësimdhënies e të gjithë "Akademikëve" dhe "Akademikëve të asociuar" të Seksionit të shkencave natyrore e teknike.

Grafikët e mëposhtëm ilustrojnë këtë veprimtari të zhvilluara nga SShNT gjatë vitit 2013, por dhe atë pesëvjeçare (2009-2013). Gjithashtu paraqiten grafikët që pasqyrojnë këtë veprimtari për ASHSH.




Fig. 8. Realizimet për vitin 2013 të Seksionit të shkencave natyrore e teknike




Fig. 9. Realizimet për vitet 2009-2013 të SShNT





Fig. 10. Realizimet për vitin 2013 të ASHSH

Fig. 11. Realizimet për vitet 2009-2013 të ASHSH



I. PROJEKTE

Akademia e Shkencave e Shqipërisë nëpërmjet anëtarëve të Asamblesë, edhe gjatë vitit 2013, është përfshirë institucionalisht apo si bashkautore në projektet e programeve të ndryshme të PKKZH që menaxhohen nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacioneve (AKTI). Gjithashtu, akademikët kanë marrë pjesë edhe në projekte në kuadër të Protokollit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Si pjesë aktive e komunitetit shkencor në universitete e në institucione shkencore, pranë universiteteve e jashtë tyre, anëtarët e Asamblesë kanë dhënë kontribut në ideimin, koordinimin e menaxhimin e projekteve të rëndësishme për kërkim e zhvillim, si në kuadër të programeve kombëtare, ashtu dhe ato rajonale, europiane dhe ndërkombëtare.

Sipas seksioneve, projektet e zhvilluara gjatë vitit 2013, renditen si më poshtë:

I. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar puna mbi disa projekte të parashikuara në planet afatshkurtra dhe afatgjata të seksionit.

A. Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

1. Projekti ***Mbi veprimtarinë e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe (2013)***. Edhe gjatë vitit 2013, Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe ka vazhduar punën sipas programit dhe tematikës së paracaktuar. Gjatë vitit, u paraqitën nga grupet e punës dhe u diskutuan në këshill çështje të gjuhës shqipe që kanë të bëjnë me leksikun, me

drejtshkrimin dhe me morfologjinë e shqipes standarde.

Në fushën e leksikut u shtruan problem të ngritura më parë dhe të reja që kanë të bëjnë me gjendjen e leksikut, me zhvillimet në këtë lëmë, të kushtëzuara nga ndryshimet e reja kulturore, sociale dhe demografike. Këshilli Ndërkademi arriti në përfundimin se në fushën e leksikut, krahas arritjeve, të përfaqësuara më së shumti e më së miri me fjalorin më të ri - *Fjalorin e shqipes së sotme*, botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2006), dalin dy detyra kryesore:

1. Pasurimi i mëtejshëm i këtij fjalori me fjalë të reja që përfaqësojnë zhvillimet politike, shoqërore, ekonomike dhe teknologjike të dy dhjetëvjeçarëve të fundit, si dhe përfshirjen në fjalor të mjaft fjalëve të tjera nga trevat e zgjeruara shqipfolëse.

2. Pastrimi, mënjanimi nga përdorimi i shumë fjalëve të huaja të panevojshme, që kanë vërshuar në shqipe kryesisht nga anglishtja dhe italishtja, por edhe nga gjuhë të tjera.

Këto detyra mund të sendërtohen vetëm nëpërmjet fuqizimit të departamentit të leksikografisë duke riorganizuar, zgjeruar e plotësuar atë me kuadrin përkatës, që t'u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të kohës.

Në fushën e drejtshkrimit, debati u përqendrua kryesisht në çështjen e drejtshkrimit të *ë*-së së patheksuar, debat që synon ta bëjë këtë përdorim sa më të thjeshtë, të përfshirë në rregulla më përgjithësuese dhe më praktike. Dy qëndrimet e kundërta, të skajshme: ***mënjanimi i sa më shumë përdorimeve të "ë"-së dhe ruajtja e saj e pandryshuar***, të cilat u shfaqën në Këshillin Ndërkademi, provokuan një reagim të gjerë nga opinioni shkencor duke e lënë të hapur çështjen.

Në fushën e morfologjisë ndryshimet u kufizuan mjaft, sipas vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972. Me mirëkuptimin e përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të Këshillit Ndërkademi, u ruajt baza normative morfologjike e vendosur në kongres. Ndryshimet ishin shumë të kufizuara; ato synuan përforcimin e përdorimit të normave ekzistuese; propozimet për ndryshime mënjantuan ndonjë përdorim morfologjik dysor të mëparshëm, saktësuan norma ekzistuese ose e plotësuan strukturën e standardit me norma të reja të pavendosura më parë. **U mënjana përfundimisht me mirëkuptim dhe me argumentim shkencor çështja e paskajores së tipit "me punue", që do të çonte në pranimin e dy standardeve gjuhësore.**

Këshilli Ndërkademi është në vazhdim të zbatimit të programit e të tematikës së paracaktuar, por tani më shumë detyra mbeten për zbatimin e standardit gjuhësor, sesa për ndryshime të mëtejshme të tij.

B. Projekte të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZH-AKTI), Protokolle të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH-AKTI) dhe programe të tjera (Cilësi dhe Barazi në Arsim, BB dhe MASH).

1. Projekti **"Metodologjia si pjesë e formimit qytetar në arsimin e**

mesëm të përgjithshëm". Projekt i financuar nga Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës. Drejtues i projektit shkencor **akad. Artan Fuga**. Projekti ka përfunduar.

C. Projekte ndërkombëtare në kuadër të Programeve të BE (FP6, FP7 etj.) dhe të organizatave të tjera.

1. Projekti **"Përgatitja e kërkesëpadive strategjike, në lidhje me respektimin e parimit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit"**, organizuar prej Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen dhe partneritetin e UNDP, Tiranë; drejtuese e projektit **akad. as. Aurela Anastasi**; afati i zbatimit (korrik 2012 - dhjetor 2013).

2. Në kuadër të Projektit të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen dhe partneritetin e Programit JUST, USAID, Tiranë, është realizuar nën drejtimin e **akad. as. Aurela Anastasi** projekti **"Forcimi i sistemit të transparencës, efektshmërisë dhe paanshmërisë në gjykatat shqiptare, përmes përmirësimit të cilësisë së përfaqësimit në gjykim dhe rritjes së aftësisë së shoqërisë civile në monitorimin dhe adresimin e këtyre çështjeve"**; afati i zbatimit të projektit (janar 2012-dhjetor 2013). Përfundimi i projektit është finalizuar me përgatitjen për botim në gjuhën shqipe të raportit të monitorimit me temë: **"Çështje të rritjes së efektivitetit, transparencës dhe të besimit të publikut në gjyqësor"**

3. Projekti **"Studim mbi Koston e Reagimit të Bashkënduar të komunitetit ndaj dhunës në familje në Shqipëri"**, realizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Shqipëri (UN Women), në kuadrin e Programit të bashkëpunimit ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, 2012-2016. Ekspertja në zbatimin e projektit, **akad. as. Aurela Anastasi**, është edhe autore e parë e botimit shqip dhe anglisht: **"Një studim i kostove ekonomike për zbatimin e legjislacionit shqiptar kundër dhunës në familje"**, Tiranë, 2013.

4. Projekti **"National Needs Assessment for Migration Counters to deliver business support services to returnees"**, projekt ndërkombëtar me pjesëmarrje të **akad. as. Kosta Barjaba**, zbatuar nga IOM dhe me financim të UNDP-së.

5. Projekti **"Transnational Networks, Transnational Entrepreneurship and the Role of State"**, me pjesëmarrje të **akad. as. Kosta Barjaba**, zbatuar nga the Regional Research Promotion Programme in the Western Balkans (RRPP), University of Fribourg, financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC).

6. Projekti **"Historia e shqiptarëve në shekullin XX"**, me pjesëmarrje të **akad. Beqir Meta**. Janë kryer kërkime në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme - Romë. Janë përfunduar pjesë të studimit për periudhën e viteve 1920-1924.

7. **"Ndikimi i Marrëdhënieve Publike në informacionin masiv"**, projekt shkencor i drejtuar nga **akad. Artan Fuga** dhe realizuar me financimin e OSBE-së. (Përfunduar).

8. Projekti **“Parametrat e trajnimit të gazetarëve të rinj në fushën e menaxhimit të medias”**, me drejtues shkencor akad. Artan Fuga. Ky projekt, i financuar nga Fondacioni “Konrad Adenauer”, është në vazhdim.

9. Projekti **“Observatori european i gazetarisë”**, në bashkëpunim me njëmbëdhjetë grupe kërkimi shkencor european në këtë fushë, drejtohet nga akad. Artan Fuga. Ky projekt mbështetet financiarisht nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor (Zvicër) dhe është në vazhdim.

10. **“Studimi i dukurive të dhunës në familje”**, projekt i financuar nga Ministria e Brendshme Suedeze, me drejtues shkencor të grupit studimor akad. Artan Fuga. Projekti ka përfunduar.

D. Aplikime të reja për projekte në kuadër të programeve e organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

1. Projekti **Botimi dokumentar “Shqipëria në dokumentet austro-hungareze të vitit 1914”**; (1913, 6 vëllime); (1914, 10 vëllime). Me drejtues akad. Beqir Meta; akad. as. Marenglen Verli.

2. Projekti **Botimi dokumentar “Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore”**, dokumente britanike; akad. Beqir Meta.

3. Projekti **“Kryengritjet e viteve 1910-1911”**, dokumente austro-hungareze; akad. Beqir Meta.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

1. Pjesëmarrje në projekte shkencore

A. Projekte të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZH–AKTI), nga Protokolle të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI) dhe programe të tjera (Cilësi dhe Barazi në Arsim, BB dhe MASH, etj.).

1. **Studimi i fushës magnetike të tokës në rrjetin mbështetës magnetik, rivlerësimi i anomalive magnetike dhe përzgjedhja e vendndodhjes së observatorit të parë magnetik të Shqipërisë**, zbatuar nga drejtuesit P. Koshe, J. Skrami, bashkëpunëtorë P. Leka, I. Jata, H. Reçi (IGJEUM) dhe drejtues shkencorë akad. S. Bushati nga Akademia e Shkencave, në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH), “Biodiversiteti dhe Mjedisi”, 2010-2014, i financuar nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit. Institucioni drejtues është Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujërave dhe Mjedisit të UPT, Departamenti i Gjeofizikës së Aplikuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe me ekspertizë të Institutit të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë (INGV), Romë.

2. **“Aplikimi i Teknologjisë së Imazheve Radar (PSIn SAR) në vlerësimin dhe parashikimin e integruar të fenomeneve gjeodinamike**

me qëllim zbutjen e pasojave në zonat urbane dhe turistike të rajonit Durrës-Kavajë", Projekt i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh) dhe i Akademisë së Shkencave, me drejtues shkencorë M. Lamaj, A. Avxhiu, L. Moisiu, M. Dardha, M. Josufati (ShGjSh) dhe bashkëpunëtorë **akad. S. Bushati** dhe **akad. N. Frashëri**, i financuar nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim "Biodiversiteti dhe Mjedisi", 2010-2013.

3. "Vlerësimi i parametrave dhe fenomeneve të ndotësve të ajrit dhe impaktet në mjedis", me drejtues shkencor **akad. F. Vila**, në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH), "Biodiversiteti dhe Mjedisi", (2010–2013). Institucioni zhvillues është FShN, UT, në të cilin janë angazhuar Departamenti i Fizikës, Departamenti i Teknologjisë Kimike (**akad. as. I. Malollari**) dhe Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, ndërsa institucionet që bashkëpunojnë janë Fakulteti i Shkencave Natyrore i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër (Departamenti i Fizikës, Kimisë dhe i Biologji – Kimisë), si dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe e Mjedisit.

4. "Ngritja e një qendre laboratorike studimore të shfrytëzimit të biomasës agropjore për biogaz dhe energji, si dhe analiza e strukturës inxhinierike të proceseve në një impiant pilot eksperimental", me drejtues shkencor **akad. as. I. Malollari**, në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH), "Biodiversiteti dhe Mjedisi" (2010-2013).

B. Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Marrëdhëniet midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) kanë një traditë të gjatë bashkëpunimi. Ato funksionojnë rregullisht mbi bazën e një marrëveshjeje në kuadër të bashkëpunimit e shkëmbimit kërkimor shkencor e artistik, e cila konkretizohet në protokollat përkatëse që rinovohen në krye të çdo dy viteve. Protokollin e fundit është protokollin për marrëveshjen në vitet 2013-2015, nënshkruar në fillim të vitit 2013.

Rezultatet e këtij bashkëpunimi shumëvjeçar janë konkretizuar me realizimin e projekteve të përbashkëta, organizimin e aksioneve shkencore të përbashkëta, të ekspeditave të përbashkëta, kërkimeve në terren dhe botimeve të përbashkëta në dy fushat e mëdha: shkencat shoqërore e albanologjike dhe shkencat natyrore e teknike.

Vitet e fundit në fushën e shkencave natyrore dhe teknike janë organizuar: Konferenca "Menaxhimi Shëndetësor në Shqipëri dhe Kosovë – sfidë madhore e sistemit shëndetësor" dhe Konferenca IV ndërkombëtare e Algjebrës dhe e Analizës Funksionale. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet ASHSH dhe ASHAK, janë realizuar disa studime që janë kurorëzuar me një varg botimesh të përbashkëta, midis tyre, *Enciklopedia e Artit Shqiptar*, *Fjalori i emrave të bimëve*, *Fjalori terminologjik i botanikës*, *Fjalori shpjegues i termave të*

botanikës, Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë, etj. Janë realizuar projekte me rëndësi, si “Gjuha shqipe dhe kompjuteri”.

Në fushën e shkencave natyrore dhe teknike po realizohen projekte të përbashkëta si: “Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë” dhe “Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës i specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri”.

Por duhet thënë se vitet e fundit janë shfaqur disa vështirësi e pengesa që kanë kufizuar mundësitë dhe ritmet e bashkëpunimit. Kjo ka ardhur, në radhë të parë, për shkak të efekteve negative të reformës së vitit 2007 në Akademinë e Shkencave dhe të uljes drastike të buxhetit për shkencën. Për këtë arsye, disa projekte të parashikuara nuk janë realizuar nga kufizimi i fondeve, si dhe për shkak të mosgjatjes në kohë të partnerëve specialistë nga ASHAK.

Grupi i përbashkët i projekteve në fushën e biologjisë, me koordinatore akad. F. Krasniqi dhe akad. L. Susuri (ASHAK) dhe **akad. J. Vangjeli** dhe **akad. as. E. Kongjika (ASHSH)**, pas disa botimeve të rëndësishme, po realizon dy projektet e poshtëshënuara:

1. Projekti “Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës i specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri” ASHSH (SShNT; FSHN - UT; UBT) dhe ASHAK (SShN) (2011 – 2013).

Projekti është realizuar nga bashkëpunimi i seksioneve të dy Akademive: Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike, ASHSH dhe Seksioni i shkencave të natyrës, ASHAK me koordinatore: **akad. as. E. Kongjika** (ASHSH) dhe akad. L. Susuri (ASHAK). Puna eksperimentale është kryer në laboratorët e Departamentit të Bioteknologjisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës; në Institutin e Virologjisë Vegjetale (CNR), Bari, dhe në Universitetin e Barit, Itali. Gjithashtu ka patur bashkëpunim me Departamentin e Hortikulturës dhe të Mbrojtjes së Bimëve, Fakulteti Bujqësi & Mjedis, Universiteti Bujqësor i Tiranës, dhe me Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve të Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti i Prishtinës.

2. Hartimi i monografisë “Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve” ASHSH (SShNT; FSHN - UT; UBT; QTTB, Vlorë, MBUMK) dhe ASHAK (SShN), me koordinatore: **akad. as. E. Kongjika** (ASHSH) dhe akad. L. Susuri (ASHAK).

C. Projekte ndërkombëtare në kuadër të Programeve të BE (FP6, FP7 etj.) dhe të organizatave të tjera.

1. Projekti “Development of hydrological and hydraulic study of regulation of Skadar Lake and Bojana River water regime” – (Zhvillimi i studimit hidrologjik dhe hidraulik i rregullimit të regjimit uhor të liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna), në kuadër të **Projektit IPA**, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Malit të Zi (partner lider) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (partner). Periudha 2012-2013. Numri i kontratës: 2012/287-023; koordinatore për palën shqiptare është **akad. S. Bushati**.

Të dyja akademitë e shkencave realizojnë kryerjen e studimit në bashkëpunim me institucionet e specializuara në fushën e hidrometeorologjisë; kështu, ASHSH bashkëpunon me Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe të Mjedisit (IGJEU) të UPT.

2. Projekti **“Innovative Approaches for Better Utilization of Local Biodiversity in SEE Based on Ethnopharmacology”** (Qasjet inovative për përdorim më të mirë të biodiversitetit lokal në EJT bazuar në Etnofarmakologjinë), aprovuar nga Komiteti i Programit Pjesëmarrës i UNESCO-s më 15 shkurt 2013; Afati i zbatimit: 31 mars 2013 - 31 mars 2014; operator: Akademia Bullgare e Shkencave - Instituti i Kimisë Organike me Qendër të Fitokimisë për *“Southeast European Network on Phytochemistry and Chemistry of Natural Products for Green and Sustainable Growth” (SEE PhytoChemNet)* (*“Rrjeti i Europës Juglindore për fitokiminë dhe kiminë e produkteve natyrale për rritjen e qëndrueshme dhe të gjelbër”*) (SEE PhytoChemNet); vendet pjesëmarrëse: Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia, Serbia. Pala shqiptare ka si koordinatore **akad. as. E. Kongjika** dhe prof. as. V. Papajani, përfaqësuese kombëtare.

3. Projekti **“HP-SEE”**, në kuadër të **Programit të Komisionit European FP7**, me drejtues të ekipit lokal **akad. N. Frashëri**.

Projekti synoi zhvillimin e infrastrukturës kompjuterike për përpunim paralel dhe të aplikimeve përkatëse në vendet e Europës Juglindore, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës.

Ka përfunduar testimi i aplikimit GIM për inversionin e anomalive gravimetrike me teknikat e paralelizmit OpenMP dhe MPI duke shfrytëzuar në distancë sistemet paralele në Hungari dhe Bullgari. Rezultatet janë paraqitur në konferenca ndërkombëtare.

Është mbështetur aplikimi i fizikës i Fakultetit të Shkencave të Natyrës HMLCQD për modelimin e *kuarkeve*, si dhe fillimi i një aplikimi të ri nga hidrodinamika. Është realizuar një seminar teknik mbi sistemet paralele. (<http://www.hp-see.eu/>). Projekti u koordinua nga Rrjeti Akademik Grek GRNET. Në Universitetin Politeknik të Tiranës u punua për aplikimin GIM për inversionin e anomalive gravimetrike me teknikat e paralelizmit Open MP dhe MPI duke shfrytëzuar në distancë sistemet paralele në Hungari dhe Bullgari; rezultatet janë paraqitur në konferenca ndërkombëtare. Projekti përfundoi në gusht 2013.

4. Projekti **“IDEALIST’ 2014”**, që financohet nga **Programi Kuadër 7 i Komisionit European** me partner në Shqipëri **akad. N. Frashëri**, synon nxitjen e pjesëmarrjes në FP7 nëpërmjet qarkullimit të informacioneve mbi projekt-propozimet dhe mbështetjen e projekt-propozimeve të tilla.

5. Projekti **“KHE-STO (IPA Adriatik) për shfrytëzimin e TIK në transport gjatë krizave mjedisore”** në kuadër të **Projektit IPA**, për rritjen e njohurive mbi transportin e qëndrueshëm me shfrytëzimin e TIK gjatë krizave mjedisore, ku mer pjesë **akad. N. Frashëri**. (<http://www.khe-sto.info/>). Krahas Universitetit Politeknik të Tiranës, nga Shqipëria në projekt marrin pjesë dhe dy OJQ – Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Qendra Kombëtare për Lëvizjen Mjedisore, me koordinator Universitetin e Aquilas, Itali.

6. Projekti “**FETCH**” që financohet nga **Programi Kuadër 7 i Komisionit Europian**, për mbështetjen e edukimit dhe trajnimit informatik në të ardhmen, me partner në Shqipëri Universitetin Politeknik, ku merr pjesë **akad. N. Frashëri**, me koordinatort Universitetin e Rosisë në Bullgari.

7. Projekti “**Emergency Damage Risk Assessment of Archaeological Monuments in Albania by new Geophysical Methods (EDRAAMG)**”. dr. H. Reçi (fellowship); **akad. S. Bushati** (mentor). Final Report of the Research Grant No.: 09-029RG/EAS/AS_C-UNESCO; FR: 3240220976.

8. Projekti “**A 4500-year ostracod record from lake Shkodra (Albania): palaeo-environmental and palaeo-climatic reconstruction using a multi proxy approach**”. **Bilateral Project Italia-Albania (CARISMA)**, 2012-2014 me autorë I. Mazzini, E. Gliozzi, R. Koçi, I.Soulie-Marsche, G. Zanchetta, I. Baneschi, L. Sadori, M. Giardini, A. Van Welden, **akad. S. Bushati**.

9. Projekti “**Materials, Physics and Nanosciences**” në kuadër të **Programit COST** (European Cooperation in Science and Technology) MP 1103”, me zgjatje (2011-2015), financuar nga Komisioni Europian. EU, nga **akad. as. A. Veveçka**, anëtare e programit.

Në kuadër të këtij programi, u mor pjesë dhe u referua në *workshop*-in ndërkombëtar “**On Energy Storage in the Grid**”, Barcelona, Janar 2014.

10. Projekti “**Vizita shkencore**” në kuadër të **Programi TEMPUS** financuar nga Komisioni Europian, EU, nga **akad. as. A. Veveçka**.

11. Projekti “**Multifunctional Nanoplatfoms for High Sensitive Pollution Control and Purification of Water**”, MICINN. (01/01/2011-31/12/2013). Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

12. Projekti “**Desenvolupament d’un biosensor electroquímic basat en nanopartícules per la detecció ràpida i senzilla de seqüències de DNA**”, subcontracted by VETGENOMICS spin-off. (01/12/2010-30/11/2013). Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

13. Projekti “**Evaluation of the calcium-sensing receptor as a novel candidate tumor suppressor gene and therapeutic target in neuroblastic tumors**”, CELLEX Foundation. (01/01/2011 - 31/12/2013). Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

14. Projekti “**Nanoparticle-based Sensors for Detection of Chemical and Biological Threats**”. (SfP 983807)”, NATO. (22/06/2010 - 21/06/2013). Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

15. Projekti “**NANOHEROES - NANOMaterials for Highly on-off Electroswitchable Recognitions capabilities with Outstanding ElectroBioSensing applications**” (MAT2011-25870), MICINN (Madrid, Spain). (01/01/2012 - 31/12/2014). Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

16. Projekti “**Nanosystems for early Diagnosis of Neurodegenerative Diseases, (NADINE)**”, FP7 Proposal for a Cooperation Project, NMP-2009-4.0-3, Development of nanotechnology-based systems for molecular diagnostics and imaging. (01/09/2010-31/08/2015), (<http://www.fp7nadine.eu>). Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

- **Merkoçi A.** Leksione “*Nanomaterials based sensors*”, *Lectures (6h) of Master Courses, Industrial Chemistry and Introduction to Chemical Research*” Chemistry Department, UAB, Spain.

- **Veveçka (Priftaj) A.** Titullare dhe hartuese e lëndës në shkollën e Doktoraturës, “*Fizika e Materialeve*”, Departamenti i Fizikës Inxhinierike, UPT.

- **Veveçka (Priftaj) A.** Titullare dhe hartuese e lëndës në shkollën e Doktoraturës, “*Nanomaterialet dhe nanoteknologjia*”, Departamenti i Fizikës Inxhinierike, UPT.

- **Veveçka (Priftaj) A.** Titullare dhe hartuese e lëndës në shkollën e Doktoraturës “*Metodat eksperimentale në fizikë. Njohuri të thelluara të shkencës së materialeve*”, Departamenti i Fizikës Inxhinierike, UPT.

- **Vila F.** Leksione në ciklet pasuniversitare: (cikli III) *Fizika e Atmosferës*, (UT, FSHN, Departamenti i Fizikës).

- **Vila F.** Leksione në ciklet universitare: (cikli I) *Fizika Moderne*, (UT, FSHN, Departamenti i Fizikës).

- **Vila F.** Leksione në ciklet universitare: (cikli II) *Bazat e Optikës, Plotësime të Fizikës, Probleme të Fizikës Moderne, Metoda zgjidhjeje të problemave të Fizikës*, (UT, FSHN, Departamenti i Fizikës).

Akad. A. Merkoçi ka një sërë bashkëpunimesh me mjaft institucione të kërkimit shkencor, brenda e jashtë vendit.

B. Kualifikimi shkencor

(Udhëheqje shkencore në nivel doktorature dhe masteri)

Doktoratura:

- **Beqiraj G.** Udhëheqje doktorate *“Implementimi i teknikave përmirësuese elastike në Cloud Computing mbi Hypervisor XEN”*. Doktorant Helidon Karçanaj, (UT, Fakulteti i Ekonomisë);

- **Beqiraj G.** Udhëheqje doktorate *“Optimizimi i inteligjencës së biznesit duke përdorur framework”*. Doktorante Blerta Moçka, (Universiteti “Kristal”, Fakulteti i Biznes - Teknologji);

- **Beqiraj G.** Udhëheqje doktorate *“Sistemet e informacionit të detarisë dhe integrimi i tyre në platforma inteligjente (rasti i Shqipërisë)”*. Doktorante Alma Stama, 2011-2013 (UT, Fakulteti i Ekonomisë);

- **Bushati S.** Udhëheqje doktorate *“Aplikimi i metodave sizmike të valëve të refraktuara dhe të reflektuara në problemet e inxhinierisë civile”*. Doktorant Erald Silo, 2012 – 2014 (UPT, Fakulteti i Gjeologjisë);

- **Durrësi A.**, Udhëheqje doktorate, doktorant Shpëtim Latifi, South East European University, Tetovë, Maqedoni;

- **Durrësi A.**, Udhëheqje doktorate, doktorante Esmeralda Make, Universiteti Politeknik i Tiranës;

- **Durrësi A.**, Udhëheqje doktorate, Indiana University Purdue University USA. Doktorantë Pinga Zhang, Yefeng Ruan, Lina Alfantoukh, Harold Owens;

- **Frashëri N.** Udhëheqje doktorate *“Aspekte të sistemeve cloud”*. Doktorante Brunela Karamani;

- **Frashëri N.** Udhëheqje doktorate *“Data Mining në kompanitë e sigurimeve”*. Doktorante Brunela Karamani;

- **Frashëri N.** Udhëheqje doktorate *“Mbi sistemet e shpërndara të rregullimit”*. Doktorant Kujtim Hyseni (Preshevë);

- **Frashëri N.** Udhëheqje doktorate *“Metodat informatike në mjekësi”*. Doktorante Elma Kolce;

- **Frashëri N.** Udhëheqje doktorate *“Probleme të sigurisë në sistemet informatike”*. Doktorant Enkli Ylli;

- **Gruda N.** Udhëheqje shkencore të doktoratës. Graduate 2nd supervisor *“Impact of fermentation on plant functional secondary metabolites”*, PhD Dase Hunaefi Technical University of Berlin, graduated July 29, 2013;

- **Haxhimihali Dh.** Udhëheqje doktorate *“Studimi i çështjeve të prodhimit të pastër në proceset e prodhimit të pijeve joalkoolike me ambalazhe plastike”* Doktorant E. Halluni, 2011- në vazhdim (UT, FSHN, Departamenti i Kimisë Industriale);

- **Kongjika E.**, Abdullahi K. Udhëheqje doktorate *“Karakterizimi biomorfologjik, fiziologjik dhe ruajtja “ex situ” e gjermoplazmës së*

specieve të "ringjalljes" së gjinisë Ramonda në Kosovë dhe Maqedoni". Doktorant Bekim Gashi 2011 - 2013, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë), mbrojtur në qershor 2013;

- **Kongjika E.**, Bacu A. Udhëheqje doktorate "Shëndetësimi in vitro i fidaneve të disa kultivarëve të mollës (*Malus domestica* Borkh.) të rrethit të Korçës me anë të kulturës së meristemës dhe kontrolli fitosanitar i tyre" Doktorante Marinela Grazhdani (Xeka) 2011 - 2014, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë);

- **Kongjika E.**, Zhaneta Zekaj. Udhëheqje doktorate "Klonimi i disa varieteteve elite të arrës (*Juglans regia* L.) në Shqipëri dhe ruajtja e tyre me disa metoda të kulturës "in vitro". Doktorante Matilda Deliaj, 2012 - 2015, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë);

- **Malollari I.**, Udhëheqje doktorate "Modelimi i fiksimit të CO₂ nga proceset termokimike e biologjike të trajtimit të mbetjeve të materialeve organike". Doktorante Hasime Manaj (Pedagoge e brendshme e Grupit të Inxhinierisë së Proceseve Kimike);

- **Malollari I.**, Udhëheqje doktorate "Përmirësimi i cilësisë mjedisore me anë të përpunimit të shkarkimeve agro-ushqimore në një sistem reaktorësh biokimikë me optimizim të parametrave operationale dhe projektimit". Doktoranti Fatmir Gjyriqi, Universiteti Duisburg-Essen, Gjermani;

- **Malollari I.**, Udhëheqje doktorate "Studimi i prodhimit të biogazit nga përzierje të mbetjeve të manureve të kafshëve dhe të aktivitetit agro-bujqësor". Doktorante Erinda Piluri (Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë);

- **Malollari I.**, Udhëheqje doktorate "Modelimi i proceseve difuzive përmes sipërfaqes kontaktuese të paketimeve me ushqimet për sigurinë dhe kontrollin cilësor". Doktorante Violeta Lajqi (Makolli), specialiste në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, Kosovë;

- **Malollari I.**, Udhëheqje doktorate "Modelimi inxhinierik i procesit të mikrooksigjenimit të verës, transformimet dhe impakti në rritjen globale të cilësisë dhe vjetërimit". Doktorant Redi Buzo, inspektor në Autoritetin Kombëtar të Ushqimeve, Pogradec;

- **Malollari I.**, Udhëheqje doktorate "Studimi inxhinierik i proceseve të kompostimit të mbetjeve organike agro-pyjore dhe projektimi i reaktorit". Doktorante Anisa Dhroso (pedagoge e brendshme e Grupit të Inxhinierisë së Proceseve Kimike);

- **Malollari I.**, Udhëheqje doktorate "Trajtimi biologjik i shkarkimeve ujore të industrive ushqimore në vendin tonë dhe projektimi inxhinierik i një impianti pilot". Doktorante Anisa Rexhepi (pedagoge e jashtme në Departamentin e Kimisë Industriale);

- **Merkoçi A.**, Udhëheqje doktorate "Improved biosensing applications using lab-on-a-chip and other platforms". Doktorante Mariana Medina Sánchez, Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona), Spain (Coodirector: S.Miserere), PhD defense (15.11.2013);

- **Merkoçi A.**, Udhëheqje doktorate "Nanomaterials Based Microarray Platforms for biodetection". Doktorant Eden Morales

Narváez nga Eden Morales Narváez, Universitat Politècnica de Catalunya, ESAII, Barcelona, Spain, PhD defense: (24.07.2013);

- **Merkoçi A.**, Udhëheqje doktorate "*Nanostructured micromaterials and devices for sensing and removing of chemical contaminants*". Doktorant Adaris Maria López Marzo Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona), Spain (Coodirector: J.Pons), PhD defense: (20.06.2013);

- **Merkoçi A.**, Udhëheqje doktorate "*Plastic and paper platforms for nanoparticle based immunosensors*". Doktorant Claudio Parolo, Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona), Spain (Coodirector: A.Escosura) PhD defense: (26.07.2013);

- **Merkoçi A.**, Udhëheqje doktorate "*Nano/Micromaterials And Motors In (Bio)Sensing Applications*". Doktorante Maria Guix Noguera, Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona), Spain, PhD defense: (15.07.2013);

- **Petro P.**, Udhëheqje doktorate "*Gjysëmgrupet eksponenciale permutabile*". (bashkëudhëheqës). Doktorante Rushadie Ramani (FSHN, Universiteti "A. Xhuvani", Elbasan);

- **Petro P.**, Udhëheqje doktorate "*Gama gjysëmgrupet inversive dhe gama unazat inversive*". Doktorant Orgest Beqiri, (UT, FSHN, Departamenti i Matematikës);

- **Petro P.**, Udhëheqje doktorate në fushën e Algjebërës "*Relacionet e Green-it dhe përgjithësimet e idealeve në unaza e përgjithësime të tyre*". Doktorante Rigena Sema (UT, FSHN, Departamenti i Matematikës);

- **Resuli B.** Udhëheqje doktorate "*Sëmundjet e mëlçisë në të sëmurët me diabet sheqeri*" (në proces). Doktorante Valdete Malaj;

- **Resuli B.** Udhëheqje doktorate "*Infektimi me virusin C (HCV) në të sëmurët e hemodializës*".Doktorante Dhurata Golemi, mbrojtur 2013;

- **Resuli B.** Udhëheqje doktorate "*Sëmundja yndyrore e mëlçisë në fëmijët obezë*". (I përfunduar, në radhë për mbrojtje)". Doktorante Klara Kodheli;

- **Veveçka (Priftaj) A.**, Udhëheqje doktorate "*Studimi i vetive të materialeve nanostrukturore të përfuara me anë të Deformimit të Fortë Plastik*" (UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike); (përfunduar dhe mbrojtur nga doktorant Neset Izairi më 19 dhjetor 2013);

- **Veveçka (Priftaj) A.**, Udhëheqje doktorate "*Vlerësimi i kompozicionit trupor dhe ndikimi i stërvitjes proprioceptive në parametrat biomekanikë, në grupmosha të ndryshme*" (UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike);

- **Veveçka (Priftaj) A.**, Udhëheqje doktrature "*Metodat e imtësimit të kokrrizave të materialeve metalike*",(UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike);

- **Vila F.**, Udhëheqje doktorate "*Studim mbi elektrizimin e materialeve jopërcjellëse*". Doktorante Pranvera Dhima;

- **Vila F.**, Udhëheqje doktorate "*Studim mbi ngarkimin elektrostatik te aerosoleve atmosferike dhe bashkëveprimin jon aerosol*". Doktorant

Edmond Lukaj, fizikan, pedagog i jashtëm (Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër);

- **Vila F.**, Udhëheqje doktrate “*Studim mbi trajtimin teorik-eksperimental të fizikës në shkollën e Mesme*”. Doktorant Alion Alizoti, pedagog (UT, FSHN, Departamenti i Fizikës);

Mastera:

- **Durrësi A.**, Udhëheqje mastera në Indiana University Purdue University, USA;

- **Durrësi A.**, Udhëheqje masteri nga studenti Aber Kalash, Pawat Chomphoosang, Pawat Chomphoosang;

- **Gruda N.**, Udhëheqje masteri Undergraduate Mentor/Bachelor’s Thesis Chairperson. Thesis title: “*Urban vegetable – The challenge for food security*” nga BSc Christina Eigenbrod Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn, graduated July 2013;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Efekti i gjenotipit, eksplantit dhe terrenit ushqyes në rigjenerimin in vitro të shegës, Punica granatum L.*”, nga Enea Alimllari, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2012 – 2013, mbrojtur në shtator 2013;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Krahasimi i organogjenezës direkte dhe indirekte në mikroshumimin e specieve endemike Forsythia europea Degen et Bald. (boshtra) (popullata e zonës së Mirditës)*” nga Aida Kaçorri, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2012 – 2013, mbrojtur në korrik 2013;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Krahasimi i organogjenezës gjatë mikroshumimit të specieve të Gesneriadeve alpine (Ramonda serbica Panç. dhe Haberlea rhodopensis Friv.)*” nga Florian Mita (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2013 – 2014;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Ndikimi i rregullatorëve bimorë të rritjes në induktimin e embriogjenezës somatike për disa kultivarë të shegës (Punica granatum L.)*” nga Malbora Kojdheli (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2013 – 2014;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Vlerësimi i disa metodave të sterilizimit dhe të shmangies së efektit të polifenoleve në fazat e para të mikroshumimit të mollës së egër, Malus sylvestris (L.) Mill.*” nga Elis Xhixha, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2013 – 2014;

- **Petro P.**, Udhëheqje masteri “*Grupi Galua i një ekuacioni dhe zgjidhja në radikale e ekuacioneve algjebrike*” me studenten Dorina Cela (UT, FSHN, Departamenti i Matematikës), mbrojtur korrik 2013;

- **Resuli B.**, Udhëheqje masteri “*Hepatokarcinoma*”, epidemiologjia, etiologjia, klinika, diagnoza” nga Marsela Tollozhina;

- **Vila F.**, Udhëheqje masteri “*Dualizmi valor – korpuskular*” me Elsa Fjora (UT, FSHN, Departamenti i Fizikës);

- **Vila F.**, Udhëheqje masteri “*Vlerësimi i përhapjes së grimcave në zonën rethuese të një fabrike çimentoje*” me Marsela Sula (UT, FSHN, Departamenti i Fizikës);

VEPRIMTARITË E SEKTORËVE MBËSHTETËS

I. DEGA EKONOMIKE

Monitorimi është mbështetur në raportimin e Akademisë së Shkencave, mbi realizimin e shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2013. Akademia e Shkencave menaxhoi fondet buxhetore të vitit 2013 në programin “Veprimtari Akademike”. Realizimi i shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2013, krahasuar me planin vjetor të miratuar, paraqitet si vijon:

Shpenzimet faktike krahasuar me fondet e buxhetit për vitin 2013:

Pasqyra 1. Realizimi i buxhetit sipas zërave

(në mijë lekë)

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti Vjetor 2013	Realizimi Vjetor 2013	Në %
1	Paga (600)	28000	23747	85
2	Sigurime shoqërore (601)	4000	3391	85
3	Shpenzime korente (602)	11000	11000	100
4	Transferta të brendshme (604)	200	200	100
5	Transferta me jashtë (605)	300	256	85
6	Transferime të brendshme (606)	36378	35308	97
7	Investime (231)	1000	888	89
8	TVSH dhe Taksa Doganore	3000	2135	71
	Totali i shpenzimeve	83878	76925	92

Shpenzimet me fondet e buxhetit sipas limiteve të miratuara u realizuan 92% sipas pasqyrave të mëposhtme.

Pasqyra 2. Niveli i realizimit të shpenzimeve në total

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	Fondi limit i vitit 2013	Fakti i vitit 2013	Ne %
1	600-601	32000	27138	85
2	602-606	48000	46764	97
	Totali i shpenzimeve	80000	73902	92

Përfundimi kryesor që nxirret nga një analizë e thjeshtë e kësaj pasqyre është: niveli i realizimit të shpenzimeve në total, për vitin 2013 në krahasim me fondet e vëna në dispozicion, arriti në rreth 92%, një rezultat ky i kënaqshëm.

Kontrolli i Lartë të Shtetit, gjatë kontrollit të veprimtarisë së ASHSH për një periudhë 8-vjeçare, deri më 2013, vlerësoi punën e bërë me tregues pozitivë.

II. DEGA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë, për të përmbushur detyrat e saj funksionale, ka krijuar në kohë të gjitha lehtësitë dhe procedurat për të siguruar një partneritet serioz me të gjitha institucionet ndërkombëtare dhe ato të vendit, me të cilat bashkëpunon. Gjithashtu, ajo ka mbështetur pjesëmarrjen e anëtarëve të ASHSH në aktivitete të ndryshme si: kongrese, konferenca, seminare, takime protokollare, takime të ndërsjella, takime në ASH dhe marrëdhënie me mediat.

Gjithashtu DMJP, në përputhje me funksionet e saj, ka kontribuar në marrëdhëniet e ASHSH me institucionet qeverisëse (MPJ, MAS, AKTI, etj.), organizmat ndërkombëtarë në vend dhe me publikun.

III. BIBLIOTEKA SHKENCORE

Në këto tri vitet e fundit, Biblioteka Shkencore (më tej BSh) e Akademisë i ka përmirësuar shërbimet e veta, veçanërisht me pasurimin e koleksionit elektronik dhe të burimeve elektronike me mundësi përdorimi nga kërkuesit shkencorë, falë edhe projekteve të organizuara me partnerë ndërkombëtarë.

Aktualisht, me fondet bibliotekare në përdorim prej 64 910 vëllimesh, BSh i ka shërbyer komunitetit shkencor, nga akademikët deri në studentët. Gjithashtu, BSh ka vënë në dispozicion instrumente dhe shërbime të karakterit digjital, në mbështetje të kërkimit shkencor.

BSh ka punuar këtë vit për të përballuar fluksin e klasifikimit të librave shqip dhe të huaj që kanë pasuruar BSh nëpërmjet blerjeve, shkëmbimit dhe dhuratave; menaxhimin e informacionit bibliografik për burimet shkencore; përgatitjen e buletineve informative mbi hyrjet e reja, në shqip dhe të huaja, duke informuar akademikët dhe profesorët, përmes kontakteve të tyre *online* në rreth 200 adresa kërkuesish shkencorë dhe lexuesish.

Si gjithmonë, biblioteka ka realizuar shkëmbime të botimeve të ASHSH me institucione shkencore bashkëpunuese dhe ka marrë prej tyre vëllime monografish dhe periodikë shkencorë.

Biblioteka Shkencore e Akademisë, në bashkëpunim me EIFL organizoi (më 13 maj 2013) një seminar, për të ndërgjegjësuar dhe rritur nivelin e informacionit të vendimmarrësit kryesorë, për mundësinë e përdorimit të burimeve elektronike të ofruara nga EIFL, mundësitë për financim të aksesimit të burimeve elektronike, si edhe rikonfirmimin e konsorciumit të bibliotekave shqiptare. Morën pjesë përfaqësues të institucioneve kërkimore dhe edukative (rektorë/zëvendësrektorë, dekanë, drejtues të grupeve të kërkimeve shkencore dhe drejtorë të bibliotekave dhe bibliotekarë përgjegjës për burimet elektronike), për

të kontribuar në vijimësinë e mundësisë së përdorimit të burimeve elektronike, të siguruara deri më tani nëpërmjet projektit ERA (Electronic Resources for Albania). Në mbledhje mori pjesë dhe përfaqësuesja e EIFL (Electronic Information for Libraries), znj. Monika Elbert.

BSh edhe gjatë vitit 2013, ka vazhduar të mbështesë komunitetin shkencor me informacione shkencore *online* nëpërmjet vazhdimësisë (me kapacitete të pjesshme) së **Projektit ERA**, falë abonimit në EIFL, realizuar në vitin 2013 përmes donacionit të IZUM. Për vazhdimësinë e projektit kërkohet mbështetje financiare prej qeverisë).

Po kështu, Projekti **“Bashkëpunimi dhe krijimi i sistemit bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në Shqipëri”**, me qëllim krijimin e sistemit bibliografik për vlerësimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në Shqipëri dhe inkurajimin e kërkuesve shqiptarë nëpërmjet sistemit COBISS, mundëson një vlerësim të shpejtë, transparent dhe të besueshëm të punës së kërkuesve shkencorë në arenën ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij projekti të përbashkët midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të Shkencave të Informacionit (IZUM), Slloveni, po punohet për trajnimin e stafit tonë bibliotekar, por edhe atij në përgjithësi, në të cilin janë përfshirë 15 biblioteka universitare të Shqipërisë, 1 bibliotekë speciale dhe 2 biblioteka publike. Nga këto biblioteka janë përfshirë në trajnim 28 punonjës. Ka filluar puna për regjistrimin e përshkrimeve bibliografike, veçanërisht të punimeve të kërkuesve shkencorë, ku deri tani rezultati është 70,042 regjistrime në bazën e përbashkët COBISS.AL. Këto regjistrime mund të shihen në bazën e të dhënave *online* (OPAC) ku përdoruesit mund të kërkojnë me elementet e kërkimit të përshkrimit bibliografik të materialeve që u nevojiten. <http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss?ukaz=CLNG&lani=al&id=0840050137107587>

PËRPARËSITË E ASHSH PËR VITIN 2014

Përcaktimi i përparësive të zhvillimit shkencor në vend, është një detyrë themelore e ASH. Përparësitë tona duhet të jenë në përputhje me nevojat dhe mundësitë aktuale të vendit, por edhe në përputhje me programet e zhvillimit shkencor të BE (p.sh., Horizon 2020 etj.), kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në projekte shkencore me cilësi të lartë (konkurruese) dhe për të fituar financime nga BE.

Pas një eksperience 5-vjeçare, paraqitet përparësori vlerësimi tërësor i kërkimit shkencor në vend, nëpërmjet studimeve nga grupe shumëdisiplinore gjithëpërfshirëse kërkuesish e politikëbërësish shkencorë, me spektër të gjerë, të drejtuara nga ASH.

Organizimi i të gjithë strukturave shkencore në kuadër të Sistemit të Kërkimit Shkencor Kombëtar, do të jetë objektivi kryesor, nga ku do të përcaktohen edhe fushat përparësore të kërkimit e zhvillimit në përputhje me programin e qeverisë për zhvillimin e vendit.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka kapacitete dhe mundësi që të rrisë rolin e saj në zhvillimin e vendit në përgjithësi, ndaj kërkohet një mbështetje nga qeveria në drejtim të zgjerimit të hapësirave të Akademisë për menaxhimin e institucioneve shkencore. Argumentet flasin pozitivisht në këtë drejtim, si përsa i përket rezultateve të veprimtarisë së saj në Sistemin e Kërkimit Shkencor në Shqipëri, ashtu edhe të përfaqësimit të saj aktive në kërkimin shkencor në vend, po kështu edhe në atë ndërkombëtar: në rrjetin e 54 akademive të vendeve të Europës (ALLEA), në rrjetin e 95 akademive të botës (IAP), të akademive të vendeve në zhvillim (TWAS), të organizmave ndërkombëtarë të shkencës (ICSU), Këshillin ndërkombëtar të vendeve të Europës Juglindore (IACSEE), anëtarësimit të akademikëve tanë në akademitë e vendeve të tjera, bashkëpunimet dypaleshe me akademitë e rajonit e më gjerë, eksperte përfaqësuese për programe të shkencës e teknologjisë të BE në fusha të ndryshme, etj. Akademia e Shkencave në planin ndërkombëtar shkëmben e transferon informacione shkencore e teknologjike e mund të quhet se është *ambasadori për kërkimin shkencor të Shqipërisë*.

Kërkimi shkencor në Shqipëri, krahas me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ka kapacitete për të qenë bashkëudhëtar drejt Europës; ekzistojnë potenciale të mjaftueshme në burime njerëzore si dhe në infrastrukturë për një fillim të mirë zhvillimi drejt Europës, por është e domosdoshme një menaxhim më i mirë i shfrytëzimit të këtyre burimeve.

Akademia, si një nga institucionet më të rëndësishme në sistemin e kërkimit shkencor, vitet e fundit ka dhënë kontribute me vlerë në procesin e hartimit të dokumenteve bazë të kërkim-zhvillimit, si:

- në hartimin e *Strategjisë Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit Teknologjik e Inovativ (SKKZHTI)*, dokumentit bazë për kërkimin shkencor;

- në plotësimin e *Pyetësorëve për Shkencën* (Kapitullit 25) të Europës, çka është udhërrëfyes për arritjet, për të qenë në bashkësinë e madhe të kërkimit shkencor europian;

- në grupin e hartimit të *Strategjisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor të Kërkim-Zhvillimit për Inovacion*;

- në mbështetje të krijimit e funksionimit të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, e në mirëmenaxhimin e programeve kombëtare e ndërkombëtare për kërkim dhe zhvillim, etj;

- në studime kombëtare për legjislacionin, përmirësimin e standardeve në botime shkencore në Shqipëri, etj.

- në ideimin e zhvillimin e projekteve madhore për rritjen e kapaciteteve institucionale shkencore, etj.

Përparësi e veçantë do të jetë bashkëpunimi me institucione homologe shkencore jashtë, në ndihmë të njohjes e integritit të Shqipërisë në bashkësinë europiane dhe në lidhjet e saj në botë, nëpërmjet rritjes cilësore të bashkëpunimeve në fusha të kërkimit shkencor, në shkencat shoqërore e natyrore-teknike.

Po kështu, nëpërmjet lidhjeve e veprimtarive kërkimore-shkencore ndërkombëtare, do të japim kontributin tonë si ASH, në përputhje me programin e qeverisë, në mbështetje të njohjes së Republikës së Kosovës nga vendet e tjera e të vlerësimit të punës së bashkëpunëtorëve tanë në Kosovë.

Nga **Seksioni i shkencave shoqërore dhe albanologjike** parashikohen disa detyra kryesore:

- *Konsultat e organizuara me anëtarë të seksionit, si një detyrë të përhershme dhe të vazhdueshme, përcaktojnë parashikimet dhe përparësitë e tematikave të rëndësishme për çdo fushë, për tani dhe për të ardhmen.*

Në fushën e *gjuhësisë*: si detyrë parësore, krahas përmirësimit e zbatimit të drejtë të rregullave të gjuhës standarde, mbetet organizimi dhe fillimi i punës për hartimin e Fjalorit të madh të gjuhës shqipe. Kjo detyrë është diskutuar me shqetësim edhe nga Këshilli Ndërkademi i Gjuhës Shqipe, i cili e ka gjykuar jo vetëm si realizim të një fjalori të gjerë (si një *thesaurus*) të gjuhës shqipe, por edhe si një vepër plotësuese dhe saktësuese në kushtet e lëvizjeve të mëdha demografike dhe të ndryshimeve politike, ekonomike, sociale etj., që kanë ndodhur në periudhën relativisht të gjatë të tranzicionit shqiptar. Fillimi dhe realizimi i kësaj vepre i kalon kufijtë e sipërmarrjes së seksionit; ai kërkon patjetër, krahas bashkëpunimit të gjerë të disa institucioneve, edhe një zgjerim me specialistë të kualifikuar, në radhë të parë, të leksikografisë.

Në fushën e *historisë*: drejtimi i kërkimit arkivor, në Lindje dhe në Perëndim, vetëm mbledhja e dokumenteve, është thujse në fillimet e veta, sidomos në arkivat e vendeve perëndimore. Edhe në këto fillime,

dokumentacioni sado i kufizuar, është i pasur edhe për historinë e Shqipërisë, por sidomos për gjerësinë e figurave të shquara të shkencës dhe të kulturës shqiptare me kontribute të rëndësishme në Perandorinë Osmane. Mandej, studimi i këtyre dokumenteve arkivore është një sipërmarrje më vete.

Detyra dhe përparësi të shumta dalin në *shkenat sociale*: si drejtim i gjerë dhe i rëndësishëm është përcaktuar asimetria e zhvillimeve shoqërore në kontekstin e zhvillimeve ekonomike, sociale, shkencore dhe kulturore të vendit.

Jeta e tranzicionit ka nxjerrë nevojën e studimeve dhe interpretimeve në fushën e *drejtësisë*. Vetë specialistët e kësaj fushe shtrojnë si detyra parësore : vështrimin kritik, zbatues dhe përshtatës të Kushtetutës së RSH; integrimin, komentimin dhe interpretimin e saj etj.

Në fushën e *ekonomisë*: krahas realizimeve shkencore të periudhës së tranzicionit, studimet vizionare dhe rekomanduese për orientime dhe vendimmarrje në politikën ekonomike janë urdhëruese.

• *Vizionet, mbështetjet, nxitjet dhe krijimtaritë e reja shkencore kanë nevojë të domosdoshme për një bashkëpunim /riorganizim institucional të drejtuar të Akademisë së Shkencave dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike, si dhe të institucioneve universitare dhe të shkollave të tjera të larta, i cili përgjithësisht ka munguar edhe për shkak të parapëlqimeve të diferencuara të institucioneve superiore.*

I. Projekte të ASHSH

Në kuadër të festimeve të ngjarjes madhore, 70-vjetorit të Çlirimit, do të zhvillohet Konferenca ndërkombëtare me temë: **“70-vjetori i Çlirimit të Shqipërisë - ngjarje e madhe historike e popullit shqiptar”**.

Për organizimin e kësaj veprimtarie do të ngrihet një komision i veçantë.

II. Projekte në kuadër të Protokollit ASHSH – ASHASHAK

Në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, do të vazhdojë realizimi i projekteve:

1. “Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe”; bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (SSHSHA, IGJL - QSA);

2. Konferencë shkencore: “Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri-Kosovë në kuadrin e integritimeve rajonale e më gjerë”, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë, 2013-2014;

3. Konferencë shkencore: “Studime albanistike”, ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë 2014;

Zhvillimi i veprimtarive të **Seksionit të shkencave natyrore dhe teknike** për kërkim e zhvillim të qëndrueshëm të vendit, do të realizohet në përputhje me përparësitë shkencore të dala nga diskutimet në seksion; kjo do të bëhet e mundur duke mobilizuar edhe akademikët për zhvillimin e strategjive afatshkurtra, afatmesme e ato perspektive, me prurje të reja, që synojnë :

- Përparësi të veçanta për fushat e shëndetësisë, të energjisë, të teknologjive të informimit dhe komunikimit, të mjedisit, të biosferës dhe njeriut, të biodiversitetit, të bioteknologjive dhe biosigurisë e ushqimit, të nanoteknologjisë, të ujërave, të pyjeve, të shkencave të tokës, të emergjencave civile, të teknologjive inxhinierike, etj. Gjithashtu, do të zhvillohen me përparësi edhe mundësitë për kontribute në disiplinat e tjera shkencore, si në trashëgiminë kulturore, në mënyrë që edhe ato të zhvillohen duke u mbështetur me teknologji të kohës.

- Realizimi i studimeve ndërdisiplinore në bashkëpunim të ngushtë midis shkencave natyrore dhe atyre shoqërore e disiplinave të tjera, me mbështetje të teknologjive inovative. Bashkëpunimi ndërdisiplinor do të rrisë cilësinë e produktivitetit shkencor në punë madhore me impakt të ndërsjellë: në fushën e gjuhës, ruajtjes e pasurimit saj, në hartimin e veprave enciklopedike, në ruajtjen e trashëgimisë kulturore e pasurimin kulturor e shpirtëror, etj., të cilat do të jenë fryt i bashkëpunimit me përfshirje të gjerë të komuniteteve shkencore, pasi zhvillimi i njëanshëm i shkencave, sjell produkt shkencor me tregues të ulët cilësorë.

- Krijimi i grupeve të punës me specialistët më të mirë të fushave, për të realizuar studime të rëndësishme të veçantë e prognoza, kombëtare e më gjerë, bazuar në fushat përparësore. Mbështetur në veprimtaritë e tyre, sipas rëndësisë së tematikës, këto grupe pune do të jenë baza e ngritjes së komisioneve *ad-hoc* apo të *përhershme*; të tilla komisione mund të jenë për fushat e arsimit dhe të shkencës, ujit, energjisë, emergjencave civile, bujqësisë dhe ushqimit, biodiversitetit, cilësisë së jetës, mjedisit. Komisionet do të udhëhiqen nga akademikë të shquar e specialistë në vend, si dhe nga specialistë që punojnë jashtë vendit, në diasporë.

- Vënia e produkteve shkencore për kërkim e zhvillim në shërbim të politikëbërësve e vendimmarrësve, shoqërisë civile dhe biznesit. Rritja e rolit të seksionit në zhvillimin e ndërsjellë Akademi-Universitet-Biznes, publik dhe privat, në zhvillimin e biznesit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) e më gjerë.

- Forcimi i kapaciteteve të seksionit për të qenë të aftë për këshillim të qeverisjes dhe shoqërisë civile, si një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit, në përputhje edhe me përparësitë e InterPanelit të Akademive të Botës (IAP).

- Përpjekje të konsiderueshme në drejtim të pjesëmarrjes së ASH në programet e BE ose në programe të tjera me karakter kërkimor, ku Akademia të përfaqësohet si koordinator ose të japë kontribut në nivel ekspertësh.

- Në të njëjtën kohë, si edhe të gjitha akademitë e botës, ASH duhet të kontribuojë në drejtim të: arritjeve të *Millenium Development Goals* (MDG) dhe pjesëmarrjes efektive në partneritetin global për zhvillim; të ndihmesës për krijimin e qendrave të *ekselencës* në disiplina përparësore, si bujqësia, qendrat e studimeve detare e të peshkimit, etj.

- Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet shkencëtarëve në institucionet brenda dhe jashtë vendit, për të cilin parashikohet të sigurohet edhe një mbështetje e madhe nga anëtarët e Akademisë jashtë vendit.

- Nxitja e të rinjve në shkencë, duke qenë në fokusin e përparësive të seksionit dhe në kuadër të Programit “Edukimi në shkencë”. Përmirësimi i imazhit të seksionit në drejtim të efektivitetit të punës së tij, të tërheqjes së brezit të ri për karrierë në shkencë, çka arrihet edhe me paraqitjen e kapaciteteve tona në komunitetin shkencor. Është koha e përshtatshme për zgjedhjen, mbështetjen dhe vlerësimin e pjesës më të mirë të kërkimit shkencor.

- Barazia gjinore dhe tërheqja e femrës në veprimtarinë shkencore e drejtuese, janë përparësi e këtij seksioni, gjë që synon rritjen e anëtarësisë së shkencëtareve femra në seksion.

- Forcimi i bashkëpunimit me akademi dhe organizata të tjera ndërkombëtare, të cilat zhvillojnë veprimtari në të njëjtat fusha. Në planin ndërkombëtar, përparësi do të vazhdojë të ketë bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe me akademitë e rajonit, si dhe bashkëpunim më i ngushtë me institucionet homologe e më gjerë, si me Rrjetin e Akademive të Botës (ALLEA), me Rrjetin e Akademive të Europës, InterPanelin e Akademive (IAP), Rrjetin e Akademive të Vendeve të Botës së Tretë (TWAS), si dhe organizmat shkencorë CNR-Itali, ato të Kombeve të Bashkuara, etj.

- Forcimi i bashkëpunimit të ASH me ministritë e ndryshme e sidomos, në kohë reale e cilësore, me Ministrinë e Arsimit e Sporteve, Ministrinë e Inovacionit e institucione të rëndësishme kombëtare.

Seksionet, gjithashtu do të vazhdojnë të kenë objektiv *partnershipin* në 5 fusha të iniciativës së “ERA”(European Research Area), që përputhen me interesat e vendit e që konsistojnë në: i) ato ndërkombëtare në shkencë dhe teknologji, ii) intensifikim të *partnershipit* në kërkim, iii) transferim teknologjish, iv) kërkime në infrastrukturë, v) zhvillimet më të reja në shkencë.

Veprimtaritë e seksionit do të zhvillohen nëpërmjet projekteve, konferencave e botimeve: monografive e periodikëve, brenda e jashtë vendit, ku janë përfshirë projekte të Këshillit të Ministrave, ato të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZh–AKTI), në kuadër të Protokolleve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI), si dhe të programeve të tjera të mbështetura nga akademitë e shkencave dhe organizmat ndërkombëtarë të tilla si: Projekti IPA, që zhvillohet ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi, si dhe projektet me përparësi në kuadër të Marrëveshjes

së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Konkretisht, do të zhvillohen veprimtaritë e poshtëshënuara:

I. Konferenca dhe simpoziume

A. Konferencë shkencore ndërkombëtare “Parandalimi dhe diagnoza e hershme e kancerit - sfidat dhe mundësitë për një impakt pozitiv në Shqipëri”

Konferenca do të organizohet në mbështetje të strategjisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për përzgjedhjen dhe trajtimin shkencor të problematikave përparësore të vendit tonë në fushën e mjekësisë dhe të mbrojtjes së shëndetit.

B. Konferencë shkencore ndërkombëtare “Zhvillimi i Teknologjive të Informacionit: teoria dhe teknologjia”

C. Simpoziumi X ndërkombëtar “Biodiversiteti, ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm për zhvillimin rural”, organizuar nga shoqata ALBAGENE në bashkëpunim me **Akademinë e Shkencave të Shqipërisë**, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Departamentin e Prodhimit Shtazor dhe institucione të tjera.

D. Konferenca e 8-të për bimët aromatike mjekësore, e vendeve të Europës Juglindore, organizuar nga shoqata për bimët aromatike mjekësore (BAM) e vendeve të Europës Juglindore (AMAPSEEC) dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës, me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

III. Projekte në kuadër të Protokollit ASHSH – ASHASHAK

Do të vazhdojë realizimi i projekteve në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

1. “Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë”;

2. Hartimi i monografisë “Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve” me koordinatörë: **akad. as. E. Kongjika** (ASHSH) dhe **akad. L. Susuri** (ASHAK), si dhe me bashkëautorë kryesorë **prof. as. A. Myrta** dhe **prof. A. Zajmi**;

3. SPALKO: Sistemet pastorale dhe kultura pastorale, trashëgimi në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe në planifikimin e territorit” me koordinatör **prof. Arsen Proko**.

III. Realizim i projekteve dypalëshe e shumëpalëshe midis:

1. Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi (*IPA-Project of the Drini River-Shkodra Lake-Buna River Water System*);
2. Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë (*bazuar në Marrëveshjen ndërmjet dy akademive*).
3. Rrjetit të Akademive të vendeve të Europës Juglindore (IAC SEE).

IV. Projekt-propozim në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:

- Nisma e një projekti për krijimin e bazës së të dhënave historike me informacione pamore mjedisore, duke synuar edhe përfshirjen e akademikëve që punojnë në fushën e mjedisit.

V. Botime dhe përrurime

- Botim i "*Excursionflora of Albania*", me koordinatör **akad. J. Vangjeli**. Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Përrurim i 6 monografive me autor **akad. as. Edmond Pinguli**;
- Botimi i dy numrave të revistës shkencore *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences (AJNTS)*;
- Botimi i revistës *Journal Agriculture and Animal Production Science for Rural Development*;
- Botimi i *Raportit vjetor të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2013*.

VI. Programi "Edukimi në Shkencë"

- Figura të shquara në shkencë:
 1. Përkujtimore me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akad. Kolë Popa dhe akad. Kolë Papparisto;
- *Ditë të hapura të institucioneve shkencore*.

VII. Tryeza të rrumbullakëta me grupe ekspertësh

- Tryezë me komisionin *ad-hoc* për problemet e ndryshme të lidhura me parandalimin dhe diagnozën e hershme të kancerit për përmirësimin e gjendjes së përhapjes së sëmundjeve kanceroze në Shqipëri.
- Krijimi i forumit shkencor "Komisioni *ad-hoc* për Yjin dhe Energjinë"

VIII. Synimet e Bibliotekës Shkencore

- Realizimi i detyrës kryesore të vitit 2014: kryerja e kontrollit nr. 4 (inventarizimi i gjithë titujve të bibliotekës), ku do të përfshihet i gjithë stafi i saj. Për këtë është miratuar edhe komisioni i posaçëm.
- Digjitalizimi i revistës *Gjuha jonë* dhe përfaqja falas për publikun.
- Ndjekja e ecurisë së dy projekteve: projekti ERA (Electronic Resources for Albania) dhe vlerësimi i rezultateve të kërkimeve shkencore në Shqipëri dhe inkurajimi i kërkuesve shqiptarë nëpërmjet sistemit COBISS.

Disa mendime për një riorganizim të strukturës administrative të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Mbështetur në konsulta të organizuara sipas porosive të dhëna nga Kryesia e Akademisë së Shkencave, si dhe në ecurinë e veprimtarisë shkencore të deritanishme, po parashtrijmë disa ide për rritjen e efektivitetit të saj, për t'iu përgjigjur më mirë programit të qeverisë së re, që synon mbështetjen dhe rritjen e kontributit shkencor të ASH për zhvillimin e vendit, në mënyrë që ajo të bëhet forcë shtytëse e veprimtarisë kërkimore në vend, përfaqësuese e denjë e komunitetit shkencor.

Duke u bazuar në programin qeveritar se “progresi shkencor konsiderohet si paraprijës i zhvillimit shoqëror, ekonomik, e kulturor, si një faktor i konsolidimit demokratik, dhe si pjesë themelore të imazhit të Shqipërisë europiane”, si dhe nisur nga fakti se për ecurinë e punës kërkimore në institucionet që u shkëputën nga Akademia ka pasur mjaft polemika në opinionin shkencor të vendit, mendojmë se ka vend për një përshtatje e diskutim lidhur me përfshirjen në akademi të qendrave të veçanta për kërkim e zhvillim. Kështu, përveç kalimit të Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Qendrës së Enciklopedisë Shqiptare pranë ASH, me krijimin e kushteve në të ardhmen, pranë Akademisë së Shkencave mund të ketë edhe institute shkencore të shkencave natyrore, teknike e inxhinierike, ku mund të ngrihen në të ardhmen institute ose qendra me objekt kërkimi përshtatjen e teknologjive të reja bioteknologjike, nanoteknologjike, të informacionit etj.

Politikat kombëtare të kërkimit shkencor janë kompetencë e qeverisë, por në këtë kontekst, Akademia e Shkencave duhet të luajë një rol parësor në rekomandimin, diskutimin e zhvillimin e këtyre politikave.

Për këtë qëllim, Akademia duhet të ideojë, të krijojë e të drejtojë me propozimin e saj grupe studimore afatmesme e afatgjata, me akademikë, profesorë e specialistë nga më të mirët në universitete e qendra kërkimore të vendit (mundet edhe me specialistë të huaj), me projekte me financim nga shteti e organizma të tij si AKTI etj.

Për të bërë realitet këtë gjë, Akademisë duhet t'i njihet ligjërisht ky status nëpërmjet dokumenteve e akteve normative, që rregullojnë bashkërendimin e punës së sektorëve kërkimorë-shkencorë në universitete, ministri, institute etj. Për këtë, në kushtet e tanishme kur kërkimi shkencor realizohet në universitete, më efektive do të ishte ndërhyrja në *Ligjin e Arsimit të Lartë* e atë të Akademisë së Shkencave.

Hap tjetër do të ishte hartimi i një strategjie të re qeveritare për kërkim e zhvillim, që përcakton vizionin dhe synimet për të ardhmen.

Akademia duhet të ngarkohet me drejtimin për hartimin e kësaj strategjie, e cila duhet të ngrëjë për këtë qëllim grupe studimore, si më sipër.

Mendimi i përgjithshëm është se ASH, me strukturën organizative që ka sot, nuk mund t'u përgjigjet me efektivitetin e nevojshëm detyrave të mëdha që kërkon kërkimi dhe krijimi shkencor i niveleve akademike në përmbushje të detyrave që shtrohen para saj nga programet shkencore qeveritare, sepse:

1. Në kushtet e sotme përgjithësisht, kërkimi dhe krijimi shkencor i Akademisë mbështetet në punën individuale të çdo akademiku në kushtet e shpërndarjes së tyre në institucione të veçanta, kryesisht universitare. Për pasojë, punët e akademikëve u nënshtrohen përgjithësisht e gjithmonë përparësive të institucioneve përkatëse, të cilat, siç dihet, në plan të parë kanë mësimin dhe detyra të tjera administrative, që lidhen me të. Ndaj drejtimet e kërkimit dhe të krijimit shkencor orientohen kryesisht në përputhje me interesat e procesit mësimor, që vetvetiu bazohen në hartimin e teksteve ose në tema të kufizuara. Sipërmarrja e temave të gjera me rëndësi jashtinstitucionale është thuajse e pamundur, sepse mungon infrastruktura teknike dhe shkencore e përshtatshme.

2. Në Akademinë e Shkencave, përfaqësimi i akademikëve sipas fushave është shumë i kufizuar. Përgjithësisht, fushat shkencore mbulohen vetëm nga një, ose së shumti, dy akademikë. Në këto kushte është e pamundur të organizohet puna ekipore, që synon zgjidhje shkencore të problemeve të mëdha e të rëndësishme kombëtare, në interes të zhvillimeve ekonomike, kulturore dhe teknike të vendit.

3. Fondet e përcaktuara për Akademinë e Shkencave, për shkak të kësaj strukture, të menduar kryesisht si një Kryesi administrative honorifike kanë qenë dhe janë mjaft të kufizuara, ndërsa pretendimet e institucioneve qeveritare dhe të opinionit të përgjithshëm kanë qenë mjaft largvajtëse, duke e përfytyruar Akademinë si një organizëm të gjerë, të pëbërë nga shumë institucione kërkimore-shkencore.

4. Sipërmarrja dhe drejtimi i projekteve të rëndësishme dhe të gjera shumëdegëshe është i pamundur, sepse këto kërkojnë bashkëpunim dhe koordinim me institucione shkencore të gjera dhe të specializuara.

Ndaj, për ta bërë më efektive veprimtarinë kërkimore dhe shkencore të Akademisë, mendohet:

1. Riorganizimi i ASH në shkallën e një reforme tërësore, duke përfshirë në përbërjen e saj institucione kërkimore-shkencore albanologjike (në fushat e: gjuhësisë, letërsisë, historisë, kulturës popullore dhe të arkeologjisë) dhe në ato të shkencave natyrore e teknike, të cilat sot përfshihen në struktura të ndryshme të sistemit të kërkimit shkencor universitar/ndëruniversitar e jashtë saj. Në përbërjen e Akademisë, padyshim duhet të përfshihet Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, e cila sot është më vete dhe me një staf të reduktuar e jo efektiv për të realizuar misionin në këtë fushë.

Një riorganizim i tillë i strukturës së Akademisë, do ta bënte shumë

efektive veprimtarinë kërkimore dhe shkencore të Seksionit të ShShA, sepse:

1. Vetë administratën qendrore të Akademisë do ta vinte në pozita aktive dhe përgjegjësie për sipërmarrje të veprave madhore dhe komplekse në shkallë institucionale dhe kombëtare. Vepra të tilla, si: *Fjalori enciklopedik shqiptar* (i zgjeruar), *Fjalori enciklopedik shqiptar* (në gjuhën angleze), *Fjalori i madh i shqipes standarde* (i plotësuar, i zgjeruar dhe i përmirësuar), vepra të plota e të gjera kombëtare nga fusha e historisë, e arkeologjisë, e sociologjisë, e ekonomisë, e filozofisë etj., mund të hartohen vetëm me një riorganizim të ri, me autoritetin dhe përgjegjësinë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

2. Qendrat studimore të fushave përkatëse, brenda strukturës administrative të Akademisë, nëpërmjet seksioneve përkatëse, do të koordinonin më mirë punën bashkëpunuese për hartimin e veprave shkencore ndërdisiplinore. Vetëm falë koordinimit dhe autoritetit akademik janë hartuar veprat më të mëdha e më cilësore shkencore kombëtare, veçanërisht në shkencat shoqërore e albanologjike.

3. Nën autoritetin e Akademisë së Shkencave, do të rritej më tej niveli dhe përgjegjësia e drejtimit administrativ dhe shkencor të këtyre fushave albanologjike.

4. Me strukturën e zgjeruar, edhe organizmat drejtues të Akademisë së Shkencave, do të gjallërohen dhe do të marrin përsipër detyra dhe përgjegjësi të reja.

5. Varësia e drejtpërdrejtë e institucioneve kërkimore-shkencore albanologjike nga Akademia e Shkencave, do të mënjanonte edhe një hallkë të tepërt administrative, siç është administrata drejtuese e Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Po kështu, edhe për **shkencat natyrore dhe teknike** do të ishte po aq efektiv një rishikim i strukturave në kuadër të ASHSH.

Me ndryshimet strukturore të ASH, ky institucion elitari shkencor do të luajë rolin e vet kryesor në kërkimin shkencor, do të sigurojë bashkëveprim në zhvillimin shkencor të programeve kombëtare, në sintetizimin dhe koordinimin e kërkimit shkencor në vend me zhvillimet ndërkombëtare.

SHTOJCË

LISTA E ANËTARËVE TË RREGULLT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

A) Me titullin "Akademik"

Nr	Mbiemër	Emër	Fusha
1	ANGJELI	Anastas	Ekonomi
2	BAÇE	Apollon	Arkeologji
3	BEQIRAJ	Gudar	Matematikë-Informatikë
4	BULO	Jorgo	Letërsi
5	BUSHATI	Salvator	Gjeofizikë
6	DADO	Floresha	Letërsi
7	DEMIRAJ	Shaban	Gjuhësi
8	DOJA	Albert	Antropologji
9	ELEZI	Besim	Mjekësi
10	FRASHËRI	Neki	Matematikë-Informatikë
11	FUGA	Artan	Sociologji
12	GRUDA	Nazim	Bujqësi
13	GJINUSHI	Skënder	Matematikë
14	HAXHIMIHALI	Dhimitër	Kimi
15	KAÇANI	Jorgaq	Mekanikë
16	KASTRATI	Adnan	Mjekësi
17	KONGOLI	Fatos	Letërsi
18	KORKUTI	Muzafer	Arkeologji
19	LIKAJ	Ethem	Gjuhësi
20	MEJDANI	Rexhep	Fizikë
21	MERKOÇI	Arben	Kimi
22	META	Beqir	Histori
23	PETRO	Petraç	Matematikë
24	RESULI	Bashkim	Mjekësi
25	SPAHIU	Xhevahir	Letërsi
26	TOLE	Vasil	Muzikologji
27	TOPALLI	Kolec	Gjuhësi
28	VANGJELI	Jani	Biologji
29	VILA	Floran	Fizikë

B) Me titullin “Akademik i asociuar”

Nr	Mbiemër	Emër	Fusha
1	ANASTASI	Aurela	Drejtësi
2	BARJABA	Kosta	Sociologji
3	DURRËSI	Arjan	Teknologji Informacioni
4	KONDILI	Anesti	Mjekësi
5	KONGJIKA	Efigjeni	Biologji
6	MALOLLARI	Ilirian	Kimi Industriale
7	PINGULI	Edmond	Ndërtim
8	SHKURTAJ	Gjovalin	Gjuhësi
9	THERESKA	Nestor	Mjekësi
10	VERLI	Marenglen	Histori
11	VEVEÇKA	Afërdita	Fizikë

LISTA E AKADEMIKËVE NË PENSION

Nr	Mbiemër	Emër	Fusha
1	AGOLLI	Dritëro	Letërsi
2	BECI	Bahri	Gjuhësi
3	FRASHËRI	Kristo	Histori
4	GOLEMI	Bardhyl	Elektronikë
5	GJERGJI	Andromaqi	Etnologji
6	HOXHA	Farudin	Hidroteknikë
7	KADARE	Ismail	Letërsi
8	OMARI	Luan	Drejtësi
9	PËRMETI	Mentor	Agronomi
10	POPA	Ylli	Mjekësi
11	PRIFTI	Kristaq	Histori
12	PUTO	Arben	Drejtësi
13	RIZA	Emin	Arkeologji
14	SULSTAROVA	Eduard	Gjeofizikë
15	TIRTA	Mark	Etnologji
16	THOMAI	Jani	Gjuhësi
17	UÇI	Alfred	Estetikë

LISTA E ANËTARËVE TË NDERIT

Nr	Mbiemër	Emër	Shteti
1	A.FRIEDMAN	Victor	SHBA
2	AJETI	Idriz	Kosovë
3	ALIU	Ali	Kosovë
4	ALTIMARI	Francesco	Itali
5	AUBOUIN	Jean	Francë
6	BARTL	Peter	Gjermani
7	CABANES	Pierre	Francë
8	CASTELLAN	Georges	Francë
9	DJUROVIC	Momir	Mal i Zi
10	DUCELLIER	Alain	Francë
11	FIEDLER	Wilfried	Gjermani
12	GUILLOU	Andre	Francë
13	HAMP	Eric	SHBA
14	INALÇIK	Halil	Turqi
15	ISMAJLI	Rexhep	Kosovë
16	J.D.DRENTH	Pieter	Holandë
17	J.FISCHER	Bernd	SHBA
18	KRASNIQI	Mark	Kosovë
19	MANG	Herbert	Austri
20	MATEVSKI	Mateja	Maqedoni
21	MURATI	Ferid	SHBA
22	QOSJA	Rexhep	Kosovë
23	QUERE	Yves	Francë
24	STAROVA	Luan	Maqedoni
25	SVANE	Gunnar	Danimarkë
26	TEODORESCU	Razvan	Rumani

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË

Veprimtaritë Kryesore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë
gjatë vitit 2013 3

PJESA E DYTË

Veprimtaritë e seksioneve të Akademisë së Shkencave
të Shqipërisë 10

Përparësitë e ASHSH për vitin 2014 68

Disa mendime për një riorganizim të strukturës administrative
të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë 76

Shtojcë 79

